



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim
Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu” Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Eglantina Hysa

2. Dr. Ana Buhajjoti

Korrik /2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Turizmit (Fakulteti i Biznesit)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim Turizëm”, me profil: “Menaxhim Hotel-Restorant”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 685, datë 25.08.2010.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nr. 7243/1, datë 22.08.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 269, datë 22.10.2020.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021: 28 PAE/8 PAK 2021-2022: 23 PAE/9 PAK 2022-2023: 17 PAE/8PAK
18	Numri i studentëve:	42 për vitin akademik 2020-2021 47 për vitin akademik 2021-2022 24 për vitin akademik 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 801, datë 20.12.2005 të Këshillit të Ministrave, i cili ofron studime të nivelit universitar në pesë Fakultete:

- **Fakulteti i Biznesit**
- **Fakulteti i Edukimit**
- **Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike**
- **Fakulteti i Studimeve Profesionale**
- **Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është akredituar institucionalisht, konkretisht, me vendimin Nr. 18, datë 24.03.2022 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe afat vlefshmërie të akreditimit deri më 23.03.2026.

Programi objekt vlerësimi Bachelor në “Menaxhim Turizëm”, me profil: “Menaxhim Hotel-Restorant”, është hapur sipas Urdhërit të VKM Nr. 685, datë 25.08.2010, dhe i riorganizuar në Nr. 7243/1, datë 22.08.2018, i cili realizohet me 180 kredite në gjuhën shqipe me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Programi organizohet nga Departamenti i Turizmit, me mbështetjen e Fakultetit të Binesit.

Fakultetit i Biznesit është i organizuar në pesë departamente:

- **Departamenti Financë Kontabilitet**
- **Departamenti i Marketingut**
- **Departamenti i Menaxhimit**
- **Departamenti i Shkencave Ekonomike**
- **Departamenti i Turizmit**

Programi Bachelor në “Menaxhim Turizëm”, me profil: “Menaxhim Hotel-Restorant” synon të ofrojë edukim profesional dhe kërkim shkencor në menaxhimin e: sistemeve të strukturave akomoduese, hoteliere e ekstra hoteliere e te gjithë sistemit HORECA. Misioni i programit lidhet me formimin e mirë me principet menaxhuese të sipërmarjeve hoteliere në drejtim të zhvillimit të turizmit modern dhe garantimit të cilësisë së shërbimeve turistike. Arritja e këtij objektivi madhor fokusohet në, sigurimin e menaxhimit të mirë e të sukseshëm të ketyre sipërmarrjeve turistike, e nevojshshme kjo, jo vetëm për rritjen e numrit të turistëve por edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve turistike e për rrjedhojë, të cilësisë së produktit turistik. Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof. Dr. Eglantina Hysa dhe Dr. Ana Buhaljoti, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Znj: Alma Arapi. Në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, grupi u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin i Biznesit, Departamentin i Turizmit. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita që u realizua pranë UAMD, Fakulteti i Biznesit në datat 26 dhe 27 Tetor 2023. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UAMD, Fakultetin e Biznesit), u realizuan takime me drejtues të njësive kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Biznesit, Përgjegjës të Departamentit të Turizmit, Grupin e Vetëvlerësimit, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19 / 86 Prot, datë 27.05.2024.”, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës njofton në ASCAL ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu” Durrës”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Aleksandër Moisiu, UAMD ofron programin e studimit Programi Studimit bachelor në “Menaxhim Turizëm” me profil “Menaxhim Hotel-Restorant”, (MTMHR) në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Ky program studimi është pjesë integrale e studimeve në Fakultetin e Biznesit, Departamentin e Turizmit dhe është hapur me VKM Nr. 685, datë 25.08.2010, dhe i riorganizuar në Nr. 7243/1, datë 22.08.2018, i cili realizohet me 180 kredite në gjuhën shqipe me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). në përputhje me interesat dhe nevojat kombëtare. Turizmi konsiderohet prioritet kombëtar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, dhe si i tillë kërkon zhvillimin e burimeve kombëtare në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvillimin e një sektori të përgjegjshëm në interesat ekonomike e shoqërore kombëtare.</p> <p>Programi i studimit “Menaxhim Turizëm” me profil “Menaxhim Hotel-Restorant” (MTMHR) synon të edukojë ekspertë në fushën e turizmit duke u ardhur në ndihmë kompanive, institucioneve dhe grupeve të interesit në industrinë e turizmit. Programi i studimit është pranë nevojave të tregut për specialistë në fushën e turizmit dhe përafron zhvillimet ndërkombëtar me interesat e industrisë dhe shoqërisë.</p> <p>GVJ ka evidentuar në Statutin e UAMD, Regulloren e UAMD, Regulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025. së UAMD ofron programe studimi që kanë për qëllim të mbështesin prioritetet strategjike të vendit përmes formimit e kualifikimit të specialistëve të fushës së ekonomisë në përputhje me vlerat akademike kombëtare.</p> <p>Sikurse u theksua më sipër, nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UAMD, GVJ konstaton se programi Bachelor në “Menaxhim Turizëm” me profil “Menaxhim Hotel-</p>




	<p>Restorant” (MTMHR) është në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Turizëm” me profil “Menaxhim Hotel-Restorant “ (MTMHR) është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e UAMD, të shprehur në Statutin (Neni 3) e institucionit. Këtu përcaktohet se UAMD synon rritjen dhe konsolidimin e standarteve akademike, përmes nxitjes së lirisë akademike, kërkimit shkencor, ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave kulturore kombëtare, duke u bërë kontribues në formimin e profesionistëve të rinj në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.</p> <p>GVJ konstaton se UAMD dhe Fakulteti i Biznesit mbështet programin e studimit Bachelor “MTMHR” dhe qëllimin e programit për sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore në edukimin dhe formimin e specialistëve të turizmit dhe hotelierë të aftë në menaxhimin e stukturave turistike në përputhje në dokumentat strategjike të institucionit.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “MTMHR” është hartuar sipas strategjisë për zhvillim të UAMD, Rregullores së UAMD, Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe Rregullores së Departamentit të Turizmit.</p> <p>Përmes evidencave dhe takimeve, GVJ konstaton se Programi Bachelor “MTMHR” është në përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me drejtimit prioritar të institucionit dhe kërkesat e tregut. Obejtvivi madhor i tij është t’u ofrojë mundësi studentëve për të kuptuar dhe shpjeguar turizmin brenda shumë dimensioneve, si: ekonomike, kulturore, politike, mjedisore duke e vlerësuar atë jo vetëm si fenomen por si një sistem biznesi. Programi i studimit është në përputhje me</p>



	<p>Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025; Plani i zhvillimit strategjik te Departamentit te Turizmit.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev. 3.5 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025.</i></p> <p><i>Ev 4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.4.1 Plani i zhvillimit strategjik te Departamentit te Turizmit</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit “Bachelor “MTMHR”. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD), është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës". Universiteti është i organizuar në gjashtë njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Biznesit; 2. Fakulteti i Edukimit; 3. Fakulteti i Shkencave Politiko-Jurisike; 4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; 5. Fakulteti i Studimeve Profesionale; 6. Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP); <p>Në përbërje të çdo njësie kryesore gjenden njesitë bazë ose departamentet, që ofrojnë programe studimi në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Departamenti i Turizmit, si njësi bazë e Fakultetit të Biznesit nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të programit të studimit Bachelor “MTMHR” duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Programi i studimit Bachelor në “MTMHR” vë në efikasitet burimet njerëzore të UAMD pasi integron stafin e departamenteve të tjera me</p>



	<p>qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave në plotësimin e profilizimit në menaxhim turizëm.</p> <p>GVJ konstaton se Statuti i UAMD, të dhënat Tabelore në Aneksin 1 të RVB për personelin akademik, të dhënat tabelore për numrin e programeve në ciklet e ndryshme të studimeve që ofrohen në UAMD si dhe tabela për ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në të gjitha programet e studimit dëshmojnë për kapacitetet e duhura në ofrimin e programit të studimit Bachelor në “MTMHR”.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev. 3.5 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025.</i></p> <p><i>Ev 4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.4.1 Plani i zhvillimit strategjik te Departamentit te Turizmit</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Aneksin 1 i RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “MTMHR” ofrohet nga Departamenti i Turizmit, i cili është pjesë e Fakultetit të Biznesit. Fusha akademike që përfshin ky departament ka të bëjë me shkencën e administrimit të biznesit dhe është në përputhje me objektivin kryesor të programit të studimit për t’u ofruar mundësi studentëve të kuptojnë dhe shpjegojnë turizmin si një sistem biznesi.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit është në përputhje me fushat didaktike dhe të kërkimit të njësisë kryesore, Fakultetit të Biznesit. Programi i studimit është në përputhje me <i>Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>; <i>VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionete arsimit të lartë”</i>; <i>Udhëzimin nr. 15, datë 04.04.2008 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”</i>; <i>Statutin e UAMD-së</i>; <i>Rregulloren e Përgjithshme të UAMD-së</i>; <i>Rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit të Turizmit.</i></p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev. 3.5 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2021-2025.</i></p>



	<p><i>Ev.4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.4.1 Plani i zhvillimit strategjik te Departamentit te Turizmit</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se UAMD ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit. Programi studimit Bachelor “MTMHR” është në koherencë me strategjinë afatgjatë të institucionit për sa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “MTMHR” bazohet në Statutin e UAMD, Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Departamentit të Turizmit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë.</p> <p>Fakulteti i Biznesit ka ngritur marrëdhënie bashkëpunimi midis departamenteve për të siguruar ecuri efektive të programit të studimit nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës. (Ev.37)</p> <p>Në Departamentin e Turizmit shqyrtohet dhe miratohet plani mësimor, programet e lëndëve (syllabuseve); tekstet mësimore në lëndët e programit të studimit; si dhe ndjekja e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar të cilësisë së mësimdhënies. Procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikëqyret nga instancat drejtuese të UAMD duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe analizë e punës së njësisive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UAMD-së.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p>

	<p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev.37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise FB</i></p> <p><i>Ev.38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev.38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.68.1 Raporti i vetevleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësues dhe formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit. Pjesë e bashkëpunimeve janë dhe përmes programit Erasmus+. Lista e bashkëpunimeve gjendet në evidencat 34, 34.1, 35, 64.</p> <p>Gjatë viteve te fundit UAMD ka nënshkruar shumë marrëveshje institucionale dhe marrëveshje me biznese e organizata. Qëllimi i tyre është trajnimi i vazhduar i studentëve, integrimi në tregun e punës, përmirësimi i programeve dhe rritje e kapaciteteve. Në evidencën 35 dhe 68.1 paraqiten informacione mbi ndërkombëtarizimin e UAMD, projektet partnere dhe mobilitetet.</p> <p><i>Ev.34. Marreveshje Bashkpunimi të Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 34.1 Tabele permbledhese me Institucione Bashkepunuese UAMD</i></p> <p><i>Ev. 34.2 Marreveshje Bashkepunimi Hungari UAMD.</i></p> <p><i>Ev.35. Raport Analitik mbi Marreveshjet e Bashkepunimit DT</i></p> <p><i>Ev.37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise FB</i></p> <p><i>Ev.38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev.38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.64. Bashkepunim me ente publike dhe private</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetevleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e</p>	<p>UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me struktura shtetërore dhe private në fushën e turizmit. Në çdo marrëveshje bëhen të qarta format e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës palë. Marrëveshjet janë të rëndësishme jo vetëm për zhvillimin e shprehive praktike të studentëve, por edhe për të rritur bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor.</p>

<p>praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p><i>Programi i studimit nuk përmban aktualisht praktikën profesionale, por GVJ konstatoi se me riorganizimin e ri të programit të studimit, praktika profesionale do të realizohet në vitin e tretë akademik i cili korrespondon me vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Ev.34. Marrëveshje Bashkpunimi të Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 34.1 Tabele permbledhese me Institucione Bashkepunuese UAMD</i></p> <p><i>Ev. 34.2 Marreveshje Bashkepunimi Hungari UAMD.</i></p> <p><i>Ev.35. Raport Analitik mbi Marreveshjet e Bashkepunimit DT</i></p> <p><i>Ev.37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise FB</i></p> <p><i>Ev.38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev.38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.64. Bashkepunimme ente publike dhe private</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetevleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Turizmit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "MTMHR" përmes strukturave të tij monitoron ecurinë e përgjithshme të punës dhe e integron në <i>Analizën Vjetore Ev.38</i> dhe Raportin Institucional vjetor të UAMD. <i>Ev. 68.1</i></p> <p><i>GVJ inkurajon departamentin për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për këtë program studimi bazuar në treguesit si: realizimi i praktikave mësimore të studentëve pranë kompanive të ndryshme, realizimi i mobiliteteve të studentëve drejt universiteteve europiane, punësimi studentëve, realizimi studimeve shkencore nga stafi akademik, etj.</i></p> <p><i>Ev.35. Raport Analitik mbi Marreveshjet e Bashkepunimit DT</i></p> <p><i>Ev.37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise FB</i></p> <p><i>Ev.38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev.38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetevleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka krijuar marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, dhe me shumë struktura shtetërore dhe private me objekt ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe aftësimin e studentëve për tregun e punës. GVJ konstatoi se me riorganizimin e ri të programit të studimit, praktika profesionale do të realizohet vitin e tretë akademik i cili korrespondon me vitin akademik 2023-2024.</i></p>



	<i>GVJ inkurajon zhvillimin e analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi Studimit bachelor në "MTMHR" është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se PS është organizuar në 6 (gjashtë) semestra me një kohëzgjatje 3 (tre) vite akademike. Ngarkesa mësimore për çdo semestër varion nga 29 ECTS në 31 ECTS. Plani mësimor është organizuar në lëndë, ku çdo lëndë vlerësohet me 4 deri në 6 ECTS. 1 ECTS është llogaritur me 25 orë punë studimi. Plani mësimor përbëhet nga 10 lëndë bazë, 18 lëndë karakterizuese, 5 lëndë ndërdisiplinore/integruese të ndryshme sipas profileve, 6 lëndë plotësuese, si dhe punimi i diplomës/provim i përgjithshëm formimi.</p> <p><i>Aneksi 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve, me njohuri dhe koncepte teorike bazë dhe aftësi praktike në aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të Hotelierisë e Restorantit. Referuar përmbajtjes së planit mësimor, programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti merr formimin e duhur teoriko-praktik, sipas profilit të zgjedhur, dhe mund të hyj në tregun e punës, ose të vazhdoj studimet në ciklin e dytë.</p> <p><i>GVJ konstatoi një përzgjedhje të kujdesshme të lëndëve të detyruara dhe atyre me zgjedhje. Studentët mund të zgjedhin katër lëndë dhe kjo</i></p>

<p>fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>mundëson profilizimin e tyre. GVJ mbasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin që ndodhej në DVV si: planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit, kurrikulën e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, si dhe nga informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, personelin akademik dhe studentët e programit të studimit, është i mendimit se ky program studimi u ofron studentëve njohuri të përparuara në profilin që ata kanë zgjedhur. Programet e lëndëve mundësojnë mendimin kritik dhe i aftësojnë studentët për punë të pavarur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë apo për vazhdimin e studimeve të thelluara.</i></p> <p><i>Aneksi 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Aneksi 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020</i></p> <p><i>Aneksi 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023 perfunduar punuar 12.09.2023</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në planin mësimor gjenden të gjitha ndarjet sipas veprimtarive formuese nga A-E dhe lëndët e përfshira në secilën kategori. Veprimtaritë formuese janë të përcaktuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndët bazë (kategoria A) kanë 40 ECTS ose 22.2% të krediteve, - lëndët karakterizuese (kategoria B) kanë 90 ECTS, ose 50.0 % të krediteve, - lëndët integruese (kategoria C) kanë 20 ECTS që zënë 11.1% të krediteve, - lëndët plotësuese (kategoria D) kanë 24 ECTS ose 13.3% të krediteve, - kategoria E e detyrimeve përmbyllëse përmban 6 ECTS ose 3.3% të krediteve të PS. <p><i>GVJ konstatoi se përqindja totale e lëndëve të kategorive nga A në E është më në përputhje me kërkesat e VKM 41, datë. 24.01.2018.</i></p> <p><i>Aneksi 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Aneksi 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, e cila ka një ngarkesë prej 6 ECTS. Në lidhje me realizimin e praktikës profesionale, GVJ konstatoi se ky PS ka të përfshirë praktikën profesionale si lëndë të</p>

	<p>vecantë në kurrikulën e planit mësimor duke filluar nga viti akademik 2021-2022.</p> <p><i>Aneksi 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Aneksi 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i si studimit Bachelor në “MTMHR” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ konstatoi se organizimi i një programi studimi, pranimi i studenteve dhe financimi i cili pasqyrohet në dokumentacionin e programit të studimit, mbështetet në hartimin e dokumentacionit themelor si kurríkula e studimeve, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 5 Rregullorja e studimeve UAMD, Kreu III, neni 43.</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu III, nenet 34, 35, 36, 37.</i> <i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 14 Dosje e Riorganizimit të Programit të Studimit Bachelor në MTMHR</i> <i>Aneksat Nr. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024).</i> <i>Aneksi Nr. 59 VKM, Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Shtojca 2.</i> <i>Aneksi_Nr.7 Rregullore studimi per programin MTMHR.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në vijim: VKM nr. 310, date 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimi i MAS nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, GVJ evidenton se PS ka përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me programet e tjera që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë.</p> <p><i>Aneksi 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Aneksi 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në vijim: VKM nr. 310, date 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimi i MAS nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, GVJ evidenton se PS shoqërohet me kodin përkatës, sipas</p>

	<p><i>fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.</i></p> <p><i>Aneksi Nr. 31 Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80:2015.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “MTMHR” ofrohet vetëm nga Departamenti i Turizmit (Fakulteti i Biznesit) i Universitetit “Aleksandër Moisiu”.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në “MTMHR” është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 180 kredite në tre vitet dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë. Përsa i përket praktikës profesionale, departamenti të marrë masat përkatëse që ky program studimi të përfshijë praktikën profesionale si lëndë të vecantë në kurrikulën e planit mësimor duke filluar nga viti akademik 2021-2022.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>IAL, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë Publik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit Bachelor në “MTMHR”. Fakulteti i Biznesit, (si një nga 5 fakultetet e Universitetit “Aleksandër Moisiu”) si njësia kryesore e këtij programi përfshin 5 njësi bazë ku Departamenti i Turizmit si një prej tyre është përgjegjës i zhvillimit të këtij programi, duke përmbushur kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” është licensuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.200 dhe i është akorduar akreditimi institucional me Vendim VBA Nr. 18, datë 24.03.2022.</p>

Fakulteti i Biznesit, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka në përbërje njësitë bazë:

- Departamenti Financë Kontabilitet
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Turizmit

Fakulteti i Biznesit në vitin akademik 2021-2022 është i përberë nga 144 Personel Akademik gjithsej, nga ku 71 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 73 Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Fakulteti i Biznesit	PAE	PAK
Prof. Dr.	5	5
Prof. As. Dr.	10	11
Dr. / PhD.	42	21
MSc.	14	36
Totali	71	73
	144	

Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e Fakultetit të Biznesit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.

Departamenti i Turizmit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2021-2022 ka këtë përbërje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Turizmit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	0	1
Prof.Asoc	3	1
Dr/PhD	17	7
Msc	2	1
Gjithsej	22	10

Departamenti i Turizmit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë përbërje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Turizmit	
	PAE	PAK

	Prof.Dr	0	0
	Prof.Asoc	4	0
	Dr/PhD	10	4
	Msc	3	4
	Gjithsej	17	8
	<p><i>Aneksi Nr. 23 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i> <i>Tabelat përmbledhëse, Tabela 7</i></p>		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislativonin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, evidentohet se Departamenti angazhon personel akademik dhe personel ndihmës akademik për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të korrekt të mësimëve laboratorike dhe dorëzimin e projekteve nga studentët e programit. Gjithashtu, personeli ndihmës akademik/administrativ angazhohet në kryerjen e praktikave mësimore në terren, sipas detajimit të programit mësimor të përcaktuar në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe të përcaktuara në planet kalendarike sipas javëve.</p> <p><i>Tabelat përmbledhëse (Tabelat 3, 4)</i> <i>Aneksi Nr 20 Syllabuset e lëndëve.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët.</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe rregullores së këtij programi janë të përcaktuara qartë gjithë problematikat lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor. Koordinator i programit të studimit organizon takime me stafin akademik dhe atë drejtues për të diskutuar mbarëvajtjen dhe çështjet e lidhura ngushtë me programin e studimit. Nga vizita në institucion evidentuam që Përgjegjësi i Departamentit të Turizmit si dhe Koordinator i këtij programi monitorojnë këtë program studimi në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e programit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit.</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e FB, Kreu II.</i> <i>Aneksi Nr. 36 Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "MTMHR", përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Gjithashtu GVJ vlerësoi përmbushjen e standardit në angazhimin e personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike, si dhe përcaktimin e një koordinatori për monitorimin sa më efikas të këtij PS.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht

18.

[Signature]

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga institucioni dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Turizmit si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat janë të arshivuara por edhe të publikuara në website e IAL.</p> <p><i>Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD, Neni 2,3,4</i> <i>Aneksi Nr.7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Vizita në institution, takimi me stafin dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në programin mësimor jepen qartë informacionet që kanë të bëjnë me ngarkesën mësimore, vlerësimin e njohurive, metodat e mësimdhënies, kriteret mbi frekuentimin dhe realizimin e praktikës, etj. Ky informacion vihet në dispozicion edhe elektronikisht në sistemin PITAGORA, ku çdo student sheh programin e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 6. Rregullore e FB, Kreu III.</i> <i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizmit të programit të studimit.</i> <i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Marrja e informacionit për kriteret dhe procesin për tu regjistruar në këtë program si dhe për studentët që po e zhvillojnë këtë program, si dhe mundësia e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullores së studimeve të UAMD; • Rregullores së Fakultetit të Biznesit; • Rregullores së programit Bachelor në “MTMHR”. <p>Njëkohësisht, GVJ konstatoi se PS përdor politika marketingu që lidhen me rritjen e transparencës përballë publikut.</p> <p><i>Aneksi Nr. 5 Rregullorja e studimeve UAMD, Kreu III, neni 56,57.</i> <i>Aneksi Nr 6 Rregullore e FB, Kreu III neni 42, 43, 44.</i> <i>Aneksi Nr 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 51 Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë</p>

<p>lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit; • Viti/semestri kur zhvillohet lënda; • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës; • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; • Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; • Format e vlerësimit të studentëve; • Detyrimet e studentit për lëndën; • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse. <p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezultojnë kontrolli periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e vlerësimit të mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kurse, provime të ndërmjetme dhe provim final. Shpërndarja e vlerësimit gjatë vitit dhe tij në provimin përfundimtar ndryshon sipas lëndëve.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstatoi se PS në “MTMHR” është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Bazuar në DVV, GVJ evidentoi syllabuset përkatëse të viteve akademike duke filluar nga 2019-2023, të cilat janë në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Gjithashtu, nga takimi me stafin rezultojnë se në programe reflektohen përditësimet sidomos lidhur me literaturë bashkëkohore.</p> <p><i>Aneksi Nr 6 Rregullore e FB</i> <i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimi MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit.</i> <i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Vizita në institucion, takimi në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Njëkohësisht, ky PS është në përputhje të plotë me Vendimin e KM Nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, duke reflektuar çdo ndryshim dhe përshtatshmëri në rregulloret përkatëse.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit evidentohet se në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të parë në fushën e Turizmit, me profil "Menaxhim Hotel-Restorant". Programi ndërtohet mbi njohuritë e bazë dhe ato të profilit të cilat shërbejnë për të thelluar njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e ekspeditave profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit të hoteleri turizmit. GVJ konstatoi se stafi akademik është i përkushtuar në mbështetjen e studentëve për të zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale që mundësojnë punësimin e të diplomuarve në industrinë e turizmit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendëve në Bachelor në MTMHR 2022-2023</i> <i>Aneksi Nr. 16 Studimi për tregun e punës në programin MTMHR</i> <i>Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e menaxhimit edhe me mundësinë për të realizuar kërkime shkencore në sektorë të veçantë të cilat ballafaqohen me natyrë të ndryshme të bizneseve në sektorin e hoteleri turizmit. Nga ana tjetër, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizës dhe modelimit të bizneseve në këtë sektor.</p> <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi, ai arrin të ketë objektiv formimin bazë në përputhje me nivelin e parë të studimeve dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve. GVJ konstatoi se ky PS siguron që studentët të kenë njohuri të mjaftueshme si dhe rrit aftësimin profesional të studentëve.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendëve në Bachelor në MTMHR 2022-2023</i> <i>Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës për specialistë në sektorin e hoteleri turizmit. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është menaxhimi turizëm me profil Manaxhim Hotel-Restorant. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Vlefshmëria e këtij program studimi është bazuar edhe në një studim tregu që mbështet nevojën për specialistë të fushës.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Aneksi Nr. 16 Studimi për tregun e punës në programin MTMHR Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke analizuar planin mësimor dhe programin mësimor të prezantuar nga e institucioni, si dhe nga bashkëbisedimi me stafin që mbulon këtë program, vërejmë se ka një raport të drejtë mes formimit teorik dhe atij praktik të studentëve që kanë preferuar të jenë menaxherë në sektorët e turizmit. Në vijim edhe të argumentimit të trajtuar më lart lidhur me strukturën e programit, shohim që ka harmonizim të trajtimeve teorike në lëndët e formimit të përgjithshëm, me grupin dominues të lëndëve të formimit profesional. Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve, GVJ evidentohet se në to kemi si trajtime teorike të avancuara ashtu edhe aplikime të metodave të menaxhim turizmit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20 Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Vizita në institucion, takimi në stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve, si dhe nga takimi me stafin në institucion, në përgjithësi evidentohet përmbajtja cilësore e elementëve të përcaktuar. GVJ konstatoi se ky PS përditësohet dhe në të gjitha syllabuset e lëndëve literatura e përdorur është ajo e 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 20, Syllabuset e MTMHR 2021-2024.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi Bachelor në “MTMHR” i pajis studentët me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhim turizmit. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të detajuara në përdorimin e teknikave të vlerësimit dhe menaxhimit në sektorin e turizmit, kryesisht hoteleri</p>

	<p>restorant, si dhe në sektorët e tjerë të ndikuar nga turizmi. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin real të turizmit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.</i> <i>Aneksi Nr. 20, Syllabuset e MTMHR 2021-2024.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por edhe ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të përbashkëta. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetëm në segmentin e sektorit e turizmit, por edhe pranë institucioneve që mbulojnë sektore reale të lidhura ngushtë me turizmin si hotele, resorte, njësi hoteliere dhe ekstrahoteliere.</p> <p><i>Aneksi Nr. 20, Syllabuset e MTMHR 2021-2024.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Bachelor në "MTMHR" është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky program studimi siguron programet e lëndëve mësimore janë të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. Njëkohësisht, GVJ konstaton se programi i studimit mbështet studentët në adaptimin më të shpejtë të tyre me kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Sipas DVV dhe vizitës në institucion u vu re një frymë bashkëpunuese ndërmjet bizneseve në fushën e turizmit dhe stafit akademik të këtij program studimi. Duke u bazuar dhe tek diskutimet me stafin drejtues dhe atë akademik të këtij PS, GVJ konstatoi se Departamenti i Turizmit ka kontakte të vazhdueshme me institucione partnere të cilat japin sugjerime të rëndësishme në lidhje me tregun e punës.</p> <p><i>Aneksi Nr. 19 Njoftim bizneseve turistike dhe shoqatave të sektorit për programin.</i> <i>Aneksi Nr. 34 Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Biznesit.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe stafin akademik të programit</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësisit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara për ta në fund të semestrit përkatës nga Departamenti i Turizmit, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me pedagogët e lëndëve.</p> <p><i>Aneksi Nr. 51.2 Takim Alumni Turizëm 2018-2019.</i> <i>Aneksi Nr. 51.3 Grupi i punës Alumni dhe aktivitetet.</i> <i>Aneksi Nr. 72, 72, 1, 72.2 Permbledhja e pyetësorit të studenteve, Modeli i formularit të vlerësimit të Google Form, Model ankete drejtuar studenteve të programit MTMHR</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit</i></p>
--	---

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Sipas DVV dhe duke u bazuar dhe tek diskutimet me stafin drejtues dhe atë akademik të këtij PS, GVJ konstaton se Departamenti i Turizmit ka kontakte të vazhdueshme me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private, të cilët shërbejnë si konsulentë për përshtatjen e programit të studimit me zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.</p> <p><i>Aneksi Nr. 17 Panairi i punës 2022, 2023 dhe forumi i karrierës.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe stafin akademik të programit</i></p>
--	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Konkretisht, Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Turizmit si njësi bazë e zhvillimit të programit kanë siguruar marrëveshje të rëndësishme në lidhje me fushën e PS të cilat shërbejnë si urë lidhëse me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1																													
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.																													
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																												
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transferimit të dijeve e njohurive në Bachelor “MTMHR” janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale dhe provim përmbyllës/diploma. GVJ konstaton se janë shprehur të detajuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve dhe janë të evidentuara në Rregulloren Fakultetit dhe të Programit të Studimit.</p> <p>Plani mësimor përbëhet nga 10 lëndë bazë, 18 lëndë karakterizuese, 5 lëndë ndërdisiplinore/integruese të ndryshme sipas profileve, 6 lëndë plotësuese, si dhe punimi i diplomës/provim i përgjithshëm formimi.</p> <p>Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit:</p> <table border="1" data-bbox="746 952 1380 1624"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Kriteri për Bachelor (VKM 41,dt. 24.01.2018)</th> <th>Kreditet përkatëse për kategori të programit</th> <th>% e ECTS /kategori të programit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>15%-20%</td> <td>40</td> <td>22.2%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>50%-55%</td> <td>90</td> <td>50%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>12%-15%</td> <td>20</td> <td>11.1%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>10-15%</td> <td>24</td> <td>13.3%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>3%-5%</td> <td>6</td> <td>3.3%</td> </tr> <tr> <td>Σ</td> <td></td> <td>180</td> <td>100%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohet në Statut, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit, që shërbejnë si referencë me nenet përkatëse.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për Departamentin e Turizmit dhe është reflektuar në dokumenta zyrtarë si Ev.4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR, Ev.4.1 Plani i zhvillimit strategjik të Departamentit të Turizmit por dhe</p>	Kategoria	Kriteri për Bachelor (VKM 41,dt. 24.01.2018)	Kreditet përkatëse për kategori të programit	% e ECTS /kategori të programit	A	15%-20%	40	22.2%	B	50%-55%	90	50%	C	12%-15%	20	11.1%	D	10-15%	24	13.3%	E	3%-5%	6	3.3%	Σ		180	100%
Kategoria	Kriteri për Bachelor (VKM 41,dt. 24.01.2018)	Kreditet përkatëse për kategori të programit	% e ECTS /kategori të programit																										
A	15%-20%	40	22.2%																										
B	50%-55%	90	50%																										
C	12%-15%	20	11.1%																										
D	10-15%	24	13.3%																										
E	3%-5%	6	3.3%																										
Σ		180	100%																										

	<p>në takimet e GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies dhe për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimin, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimin të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gadishmërinë e pedagogëve.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev 4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.4.1 Plani i zhvillimit strategjik te Departamentit te Turizmit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev.112.1 Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2021-2024.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me stafin akademik dhe <i>evidencat 81,81.1, 112.1</i> u evidentua se personeli akademik u ofron studentëve metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në Menaxhim Turizëm me profil “Menaxhim Hotel- Restorant”. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimit e informacionit teorik.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se risi e programit të studimit ishin dhe vizitat studimore me synim trainimin dhe aftësimin praktik të studentëve, si dhe diskutime dhe punë në grupe, të cilat nxisin interesin dhe të menduarit e tyre.</p> <p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev 4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev.112.1 Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2021-2024.</i></p>

	<p><i>Ev. 81. Aktivitete te kryera nga departamenti i Turizmit, v.a 2020-2022</i></p> <p><i>Ev.81.1 Lektorime te hapura nga anetaret e stafit akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMD mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet homologe. Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore.</p> <p>Gjithashtu në funksion të përmbushjes së nevojave të personelit akademik mbi kopetencat didaktike shërben dhe Qendra për Edukimin e Vazhduar e cila ofron trajnime për stafin e UAMD-së. <i>Ev.39</i></p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve, UAMD ka në dispozicion infrastrukturën dhe laboratorët ku stafi akademik, përdor mjete audio-vizive të mësimdhënies dhe studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p><i>Ev. 34. Marrëveshje Bashkpunimi të Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 34.2 Marreveshje Bashkepunimi Hungari UAMD</i></p> <p><i>Ev 73.2. Lista e Marrëveshjeve për Mobilitete UAMD.</i></p> <p><i>Ev 73.1 Tabele permbledhese per mobilitetet te stafit akademik te DEv.</i></p> <p><i>35. Raport Analitik mbi Marreveshjet e Bashkepunimit DT</i></p> <p><i>Ev. 38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev. 38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev.39. Trajnimi i stafit QEV-Udhezues institucional per perdorimin e metodave te ndryshme ne mesimdhenie</i></p> <p><i>Ev. 42 Te dhena per Infrastrukturen ne funksion te programit te studimit</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetevleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p>	<p>Personeli akademik, i angazhuar në mësimdhënie për Programin e Studimit në Bachelor “MTMHR” është në përshtatshmëri me profilin e lëndës që zhvillon. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është prej vitesh pjesë e UAMD, dhe kompetencat e kualifikimi i stafit akademik jepen në mënyrë të detajuar dhe në CV-të e tyre. <i>Ev 21 .CV stafi akademik i Departamentit te Turizmit.</i> Njësia bazë planifikon ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara nga udhëzimet e MASR, në shkallën e kualifikimit, të eksperiencës dhe fushën e kompetencës të çdo anëtari të personelit akademik, si dhe në numrin e grupeve mësimore për programet e studimit ku është i përfshirë.</p>

<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve dhe dokumentacionit të personelit akademik, GVJ konstaton se fusha e ekspertizës së pedagogëve përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar dhe mbështesin studentët përmes metodave interaktive të evidentuara dhe në Programet e Lëndëve.</p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 21 .CV stafi akademik i Departamentit te Turizmit.</i></p> <p><i>Ev 22. CV e Stafit Ndhmës Akademik.</i></p> <p><i>Ev 23. Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Njesine Kryesore dhe në Njesine Pergjegjese</i></p> <p><i>Ev 24. Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik të programit të studimit</i></p> <p><i>Ev. 38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev. 38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p> <p><i>Ev. 65.Fushat e studimit të lektorëve të Departamentit të Turizmit</i></p> <p><i>Ev 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i></p> <p><i>Ev. 81. Aktivitete te kryera nga departamenti i Turizmit, v.a 2020-2022</i></p> <p><i>Ev.81.1 Lektorime te hapura nga anetaret e stafit akademik</i></p> <p><i>Ev.112.1 Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2021-2024.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së UAMD. <i>Ev.2 Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës;</i> Studentët bëhen pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të UAMD-së, anketimit periodik, takimet e hapura dhe komunikimi me koordinatorin e programit të studimit i cili vlerëson dhe adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Me rëndësi të veçantë në këtë proces është dhe anketimi i realizuar nga Rektorati dhe NJSBC çdo fund semestri si mënyra kryesore për tërheqjen e mendimit të studentëve.</p> <p><i>Ev.2 Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev. 13. Përfshirja e studenteve ne organet vendimarrëse te UAMD</i></p>

	<p><i>Ev 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.66.1 Monitorim i procesit te mesimdhënies nga NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 68. Formularët e vetvleresimit te performances së Pedagogut</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetvleresimit te brendshem viti akademik 2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UAMD është angazhuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies me ngritjen e strukturës të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, dhe Drejtorisë së Kurrikulës të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe për përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. NJSBC gëzon autonomi të plotë në veprimtarinë e saj dhe planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Për këtë qëllim ajo bashkëpunon me autoritetet dhe strukturat përkatëse të institucionit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p>Gjithashtu, UAMD trajnon personelin akademik përmes Qendës së Edukimit në Vazhdim (https://uamd.edu.al/qendra-per-edukim-ne-vazhdim/). GVJ u informua në takimin me NJSBC se stafi akademik i cili vlerësohet më pak në anketimet e studentëve, zhvillon trajnime të vazhduara përmes qendrës sipas planifikimit të njësisë bazë.</p> <p><i>Ev. 8 Rregullore e NJSBC UAMD</i></p> <p><i>Ev. 99 Manual per Sistemin e Brendshem per Sigurimin e Cilesise ne Fakultetin e Biznesit_V.A. 2018-2019</i></p> <p><i>Ev. 115. Vendim NjSBC e Fakultetit te Biznesit</i></p> <p><i>Ev 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.66.1 Monitorim i procesit te mesimdhënies nga NJSBC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohet në Statut, Rregulloren Institucionale dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Pjesa më e madhe e moduleve të programit përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së UAMD.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ konstatoi se mënyra e kontrollit të dijeve në UAMD përcaktohet në Rregulloren Institucionale, Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor “MTMHR”.</p> <p>Njohuritë e përftuara nga studenti kontrollohen përmes frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësim, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti.</p> <p>GVJ konstaton se në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024)</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Personeli akademik i programit Bachelor “MTMHR” në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përputhje me Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Fakultetit dhe atë të programit të studimit. Në programin e lëndës shprehen mënyrat e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentit me fillimin e procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të syllabusit përkatës, i cili përmban metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p>

	<p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Instrumente në kontrollin e vazhdueshëm, përpara provimit përfundimtar përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Raste studimore <input type="checkbox"/> Punë në grupe <input type="checkbox"/> Detyra Kursi <input type="checkbox"/> Projekte Kërkimore <input type="checkbox"/> Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit) <p>Kontrolli përfundimtar i dijeve së një lënde (provimi përfundimtar) bëhet me shkrim duke u mbështetur në programin mësimor.</p> <p>Pedagogu i lëndës i komunikon studentit, në orën e fundit të mësimit të drejtën e paraqitjes ose jo në provim; nivelin e pikëve të fituara në format e tjera të kontrollit të vazhdueshëm; kriteret e vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Rregulla dhe specifika të provimeve, përqindja e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve në fillim të procesit mësimor.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Studentët marrin pjesë në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë së UAMD bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Studentët bëhen pjesë e përmirësimit të cilësisë përmes përfaqësimit të tyre në organet dhe strukturat përkatëse të UAMD-së, anketimit periodik, takimet e hapura dhe komunikimi me koordinatorin e programit të studimit. Departamenti i Turizmit vlerëson dhe adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e</p>

<p>duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mësimdhënies. Anketimi i realizuar nga NJSBC çdo fund semestri është mënyra kryesore për tërheqjen e mendimit të studentëve. Mendimet e tyre reflektohen në përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Gjithashtu, titullari i lëndës në përfundim të procesit mësimor, jep mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe përmirësime në programin e lëndës.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 40. Formati i Pyetesorit për pedagoget nga studentet.</i></p> <p><i>Ev 66. Informacion mbi rezultatet e vlerësimit të stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i></p> <p><i>Ev.66.1 Monitorim i procesit të mesimdhënies nga NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 68.1 Raporti i vetevlerësimit të brendshëm viti akademik 2020-2021</i></p> <p><i>Ev 72.2 Modeli Ankete drejtuar studenteve të programit të Bch MHR</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ u informua se stafi nxiti studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemave në seminare. Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë u evidentua nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion ku u theksua se studentët kanë mbështetje në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte e hartimin e diplomës dhe vizitave studimore pranë bizneseve.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 20. Programet e Lendeve në Bachelor në MTMHR 2022-2023</i></p> <p><i>Ev 81. Aktivitete të kryera nga departamenti i Turizmit, v.a 2020-2022</i></p> <p><i>Ev.86. Memo dhe rregullore për organizimin e ekspeditës mësimore me studentët e ciklit bachelor</i></p> <p><i>Ev. 87. Relacion për ekspeditën mësimore.</i></p> <p><i>Ev. 112 dhe 112.1 Planet mësimore të programit të studimit, MTMHR për vitet akademike 2018-2021 dhe 2021-2024)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njohuritë e përfuara nga studenti kontrollohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në</i></p>

	<i>auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Forma e vlerësimit të mësimnxënies në nivelin bachelor në UAMD bëhet në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë zhvillimit të lëndës. Format kryesore të kontrollit të vazhduar të dijeve janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare, detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim përfundimtar.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i Syllabusave konstaton se në asnjë rast nuk kemi një rezultat përfundimtar të kontrollit të dijeve bazuar vetëm në rezultatin e provimit përfundimtar.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit vlerësimi organizohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyra Kursi- 10% • Provim i Ndërmjetëm – 40% • Provim Përfundimtar- 50% <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve në Bachelor në MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UAMD ka në përdorim sistemin elektronik të vlerësimit Clean Score i mundësuar nga AADF dhe garanton shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm të vlerësimit të studentëve. GVJ u informua gjatë takimit se Clean Score përdoret dhe për matjen e performancës së mësimdhënies në bazë të vlerësimit të studentëve për performancën e lektorëve. Edhe ky proces kryhet në mënyrë të automatizuar përmes CleanScore, duke maksimalizuar vërtetësinë e gjetjeve.</p> <p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, Fakulteti i Biznesit</p>

	<p>gjithashtu përdor Sistemin e brendshëm Pitagora i cili u mundëson Studentëve informacion lidhur me programin e lëndës, vlerësimet e tyre, etj. Gjatë pandemisë Fakulteti ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe Classroom janë zhvilluar seanca mësimore online, ndërsa me rikthimin në auditor, platforma po përdoret për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione etj.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev. 39.1. Sistemi Pitagora-RASH</i> <i>Ev. 39.2 Vlerësimi me clean score</i> <i>Ev. 46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, Ev. 46.1 Udhëzues për përdorimin e platformave online Classroom, Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Bachelor MTMHR bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në syllabuset e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet brenda shtatë ditëve nga data e dhënies së provimit. Pas këtij afati pedagogu hedh notën në sistem dhe dorëzon procesverbalet në sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve në Bachelor në MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vlerësimit të gjithë elementëve të një moduli si provim i ndërmjetëm, detyra e kursit, dhe provimi përfundimtar, stafi akademik bën komente me shkrim gjatë korrigjimit në tezën e provimeve ose komente direkte në rastin detyrave/projekteve të kursit, të cilat ndihmojnë studentin në përmirësimin e njohurive si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë këtij procesi. Lektorit i bën me dije studentit për rezultatin e vlerësimit përpara plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të paraqesë pretendimet e tij për rezultatin e marrë.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ndjekja individuale i ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies. Gjithashtu në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit</p>

	<p>dhe Rregulloren e Programit të studimit parashikohet ballafaqimi i vlerësimit të provimeve me studentët.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në Rregulloren e UAMD dhe Rregulloren e Fakultetit të Biznesit janë të specifikuara qartë veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të provimit, përfshirë edhe kopjimin në provim. dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi. Komisioni i provimit vë në dijeni drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, për të proceduar më tej në përputhje me Kodin e Etikës.</p> <p><i>Lidhur me plagjiaturën në detyra kursi, apo tema diplome, ajo nuk mund të evidentohet pasi në institucion mungon një program specifik për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit.</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e kontrollit të dijeve në UAMD përcaktohet në Rregulloren Institucionale, Rregullore e Fakultetit të Biznesit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor “MTMHR”.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët u konfirmua se vlerësimi është transparent dhe nuk ka patur raste të shkeljes së meritës.</p> <p>GVJ konstaton se në programet e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Tezat hartohen në mënyrë që të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit tezat e korrigjuara dorëzohen brenda një jave nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda dy javëve nga data e zhvillimit të provimit.</p>

	<p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit.</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit bazuar në rregulloren dhe procedurat përkatëse.</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka zhvilluar procedurën e rishikimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë një kërkesë me shkrim përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Dekanati në bashkëpunim me Përgjegjësin e Departamentit ngrë një komision i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i komisionit mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.</p> <p>Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit.</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, dhe kërkuar rishikim të vlerësimit. Procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët në programin e studimit Bachelor në MTMHR bëhet në përputhje me përcaktimet në Rregulloren Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në programet e lëndëve shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.****Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.

Programi i studimit Bachelor "MTMHR" garanton formimin e specialistëve me njohuri dhe koncepte teorike bazë dhe aftësi praktike në aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të Hotelarisë e Restorantit. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti merr formimin teoriko-praktik, sipas profilit të zgjedhur. GVJ shqyrtoi planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit, kurrikulën e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, si dhe konstatoi se ky program studimi u ofron studentëve njohuri të përparura në profilin që ata kanë zgjedhur. Programet e lëndëve mundësojnë mendimin kritik dhe i aftësojnë studentët për punë të pavarur në sektorin e turizmit apo për vazhdimin e studimeve.

Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 dhe përmban:

- lëndët bazë 40 ECTS ose 22.2% të krediteve,
- lëndët karakterizuese 90 ECTS, ose 50.0 % të krediteve,
- lëndët integruese 20 ECTS ose 11.1% të krediteve,
- lëndët plotësuese 24 ECTS ose 13.3% të krediteve,
- detyrimeve përmbyllëse 6 ECTS ose 3.3% të krediteve.

GVJ konstaton se programi i studimit mundëson zhvillimin e aftësive teknike, ndërpersonale dhe konceptuale që mundësojnë punësimin e të diplomuarve në industrinë e turizmit.

Ev. 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të Fakultetit të Biznesit 2016-2020
Ev.7 Rregullore e programit të studimit MTMHR.

Ev. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit MTMHR.
Ev. 20. Programet e Lendëve në Bachelor në MTMHR 2022-2023
perfunduar punuar 12.09.2023

Ev. 112. Plani mesimor i Bch në MHR për vitin akademik 2018-2021

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të

Në fillim të çdo lënde studentët informohen nga titullari i lëndës mbi programin e lëndës, objektivat, kompetencat dhe aftësitë që pritet të

<p>paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>fitojë studenti gjatë zhvillimit të lëndës. Në fund të modulit këto elementë shqyrtohen dhe analizohen përsëri për të vënë në dukje arritjet e studentëve.</p> <p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë seanca konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e studentëve për provimin përfundimtar.</p> <p>UAMD tregon vëmendje lidhur me bashkëveprimin me studentët, si një proces periodik. Nga takimi me studentët, GVJ kuptoi se ata ndihen të lirë dhe të motivuar për të pyetur për çdo paqartësi lidhur me orët e leksionit/seminarit.</p> <p><i>Ev.7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Ev. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023 perfunduar punuar 12.09.2023</i> <i>Ev. 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në programet e lëndëve dhe në rregulloren mësimore të programit të studimit, paraqiten format kryesore të punës mësimore teorike e praktike, ku përfshihen leksionet, seminarat, ushtrimet, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projekt – diplomat, etj.;</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët dhe stafin akademik u konstatua se në çdo lëndë u jepet mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në projekte dhe rastet studimore. Përmes tyre studentëve u krijohet mundësi të zhvillojnë të menduarin kritik dhe analizën në funksion të nevojave të tregu të punës. Detyrat e kursit u japin mundësinë studentëve të analizojnë një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga industria, sipas udhëzimeve të pedagogut.</p> <p>GVJ nga takimet me stafin e studentët u informua se risi e programit të studimit ishin dhe vizitat studimore me synim trainimin dhe aftësimin praktik të studentëve, të cilat nxisin interesin dhe të menduarit kritik.</p> <p><i>Ev.7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i> <i>Ev. 14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR.</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023 perfunduar punuar 12.09.2023</i> <i>Ev. 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u njoh me aktivitetet e mbajtura si trajnime, leksione me të ftuar të industrisë, ekspedita studimore dhe tryeza të rumbullakëta. Përshkrimi i këtyre aktiviteteve është evidentuar në <i>Ev 87. Relacion per ekspeditën mësimore; Ev 90. Relacion mbi aktivitetet, trajnime nderkombetarizime te stafit te Dep Turizmit.</i></p>

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>GVJ inkurajon bashkëpunimet e UAMD me Universitete e Institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbime dhe adoptimin e zhvillimeve të reja të shkencës në funksion të ndërkombëtarizimit të programit të studimit.</p> <p><i>Ev 38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i> <i>Ev. 81. Aktivitete te kryera nga departamenti i Turizmit, v.a 2020-2022</i> <i>Ev 86. Memo dhe rregullore për organizimin e ekspeditës mësimore me studentët e ciklit bachelor</i> <i>Ev 87. Relacion per ekspeditën mësimore.</i> <i>Ev 89. Mesim i hapur tek Melia resort.</i> <i>Ev 90. Relacion mbi aktivitetet, trajnime nderkombetarizime te stafit te Dep Turizmit.</i> <i>Ev 91. Organizim aktiviteti me RISIALBANIA</i> <i>Ev 92. Relacion mbi leksion i hapur në organizimin e eventeve</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ vlerëson se Programi i Studimit Bachelor "MTMHR" është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti merr formimin teoriko-praktik, sipas profilit të zgjedhur. Risi e programit të studimit janë dhe vizitat studimore me synim trainimin dhe aftësimin praktik të studentëve, të cilat nxisin interesin dhe të menduarit kritik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>UAMD ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit.</p> <p>Diploma zhvillohet në përputhje me kriteret dhe standartet e përcaktuara nga njësia të cilat bëhen publike përmes Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Biznesit, Rregullores e programit të studimit, rregullores së diplomimit.</p> <p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, dhe rregulloren e Diplomimit, studentët e ciklit të parë të cilët kanë një mesatare mbi notën 7 zhvillojnë një punim diplome si detyrim përmblylës, ndërsa studentët me mesatare nën notën 7 zhvillojnë provimin e përgjithshëm përfundimtar si detyrim përmblylës. Departamenti i Turizmit përcakton kriteret dhe asiston studentët në zhvillimin e provimit përmblylës ose punimit të diplomës.</p>

	<p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjatë takimeve me përgjegjësin e departamentit dhe stafin, GVJ u informua se departamenti vë në dispozicion një grup pune të përbërë nga personeli i tij akademik me funksion koordinimin dhe mbështetjen e studentëve për procesin e diplomimit.</p> <p>Studentëve ju mundësohen seanca metodologjike sipas një kalendari takimesh të përcaktuar nga pedagogët udhëheqës si dhe ju vihet në dispozicion udhëzuesi për përgatitjen e Mikrotezës.</p> <p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit Bachelor “MTMHR”</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Biznesit, dhe rregulloren e Diplomimit, detyrimi përmbyllës i programit të studimit bëhet me punim diplome për studentët me mesatare mbi notën 7 dhe me provim të përgjithshëm për studentët me mesatare nën notën 7.</p> <p>Grupi i punës i përbërë nga koordinatori i programit dhe pedagogët udhëheqës për procesin e diplomimit orientojnë studentët në përcaktimin e temave të diplomave. Studentëve u vihet në dispozicion një listë me tema të sugjeruara të punimit të diplomës, të përgatitura nga stafi akademik në përputhje me fushat kërkimore të programit të studimit në “Bachelor MTMHR”.</p> <p>Procedurat e mbrojtjes së diplomës përfshijnë një paraqitje të përmbledhjes së punimit të diplomës, dhe në vlerësimin e saj merren në konsideratë njohuritë dhe arritjet akademike të studentit gjatë ciklit të studimeve, vlerësimi nga udhëheqësi i mikrotezës, dhe vlerësimi i jurisë.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>

	<p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ u njoh me procedurën e diplomimit të studentëve nga takimi në institucion dhe Rregullorja e Diplomimit. Sipas procedurës, studenti propozon pedagogun udhëheqës pasi ka marrë paraprakisht dhe aprovimin e këtij të fundit. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e kërkimit të studentit. Përgjegjësi i departamentit miraton listën e temave dhe udhëheqësve shkencor. Gjatë seancave orientuese studentët asistohen nga pedagogu udhëheqës për përcaktimin e temave të diplomës dhe përmbajtjen e saj. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ u informua se UAMD vë në dispozicion të studentëve 2 laboratorë dhe pajisjet që ata disponojnë për kryerjen e mbledhjes së të dhënave, analizave, si dhe asistencë në përgatitjen e prezantimit të punimeve. GVJ gjykon se UAMD ka kapacitetet e duhura për zhvillimin e diplomës. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores së Diplomës dhe Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave. Komisioni bën vlerësimin unanim por të bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në notë.</p>

	<p>Në përfundim të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studenti notën me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën punimit të tij, ai mund të rimbrotë të njëjtin punim ose të mbrojë një punim të ri, në një afat kohor i cili përcaktohet në rregulloren e programit të studimit, pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas Rregullores së UAMD , studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p> <p>Diplomat për ciklin e parë të studimeve shoqërohen me suplementin e diplomës i cili hartohet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Studenti ka të drejtë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 15. Model Diplome, Aprovimi nga MASR e QSHA</i> <i>Ev. 15.1 Supplement i ri 2022-2023</i> <i>Ev.15.2 Diplomë dhe Supplement i Diplomës</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se dokumentacioni i studentit ruhet në sekretarinë mësimore. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, një kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikime ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i></p>

	<i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 54. Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit ne UAMD.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi UAMD ka rregullore dhe procedura të miratuara për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e zhvillimit dhe mbrojtjes së diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) ku specifikohet informacioni në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se UAMD ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër. Nga të dhënat e paraqitura rezulton si në vijim: - Në vitin akademik '20-'21 janë angazhuar: 28 PAE , me kualifikimin 2 Prof. Dr., 4 Prof. As., 18 Dr. Dhe 4 Msc., dhe 8 PAK , me kualifikimin 3 Dr. dhe 5 Msc. - Në vitin akademik '21-'22 janë angazhuar: 23 PAE , me kualifikimin 3 Prof. As.Dr, 16 Dr. Dhe 4 Msc., dhe 9 PAK , me kualifikimin 3 Dr. dhe 6 Msc.

	<p>- Në vitin akademik '22-'23 janë angazhuar: 17 PAE, me kualifikimin 4 Prof. As., 10 Dr. Dhe 3 Msc., dhe 8 PAK, me kualifikimin 4 Dr. dhe 4 Msc.</p> <p>Për sa më lart, konstatohet se programi i studimit të ciklit të parë "MTMHR" është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p>GVJ konstatoi se ky PS ka të detajuara dhe të përshtatura një bazë të dhënash për personelin akademik që realizon programin.</p> <p><i>Aneksi Nr.21 CV Stafit akademik Departamenti Turizmit</i> <i>Aneks Nr.25. Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik të programit të studimit</i> <i>Aneksi Nr.11 Aneksi 11.1 Rregullore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore, 246.1 Aneksi 11.1 Politika te BNJ, Politika te punesimit</i> <i>Aneksi Nr.23 Të dhëna Tabelare për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Përgjegjëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e përcjella nga UAMD, mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 2021-2022: 68.9% (1395 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 31.1% (630 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK. - Në vitin akademik 2022-2023: 73.3% (1485 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe 26.7% (540 orë) e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAK. <p>Për sa më lart, konstatohet se në vitin e fundit akademik ngarkesa mësimore mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv.</p> <p><i>Aneksi Nr 135 Urdher Rektori per emerimin e personelit me kohe te pjeshme MTMHR sem I 2022-2023</i> <i>Aneksi 24 dhe Aneksi 25. Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me</p>	<p>GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e dorëzuar si edhe njoftimet publike në faqen e internetit të Institucionit për disa njoftime për vende pune të publikuara në faqen e internetit. GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik me grade shkencore kanë një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel i cili është prej vitesh pjesë e UAMD,</p>

<p>sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Kontratat e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme hartohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>Aneksi Nr. 24 Të dhëna tabelare për personelin akademik ne programin e studimit</i> <i>Aneksi Nr.30 Të dhëna tabelare për njësitë, individët e studentët të angazhuar në Sisteme Sigurimeve</i> <i>Aneksi Nr. 111, 111.1, 111,2 Kontratat e punes per stafin akademik full time, part time dhe te FTI,</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi formalizimin dhe funksionimin e procedurave për rekrutimin e personelit akademik. Institucioni angazhon, në varësi të nevojave të tij staf akademik me kohë të plotë, me kohëzgjatje të caktuar ose me kohëzgjatje të pacaktuar, si edhe staf akademik me kohë të pjesshme siç u verifikua nga tabelat e të dhënave. Procesi i seleksionimit të kandidatëve kalon në disa faza, procesi kryhet në mënyre transparente dhe aplikantët njoftohen në secilën fazë, deri në pranimin në punë të kandidatëve të përzgjedhur. Procedura e rekrutimit fillon me konstatimin e vendeve vakante nga ana e njësisë bazë e cila harton një kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Njëkohësisht, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidaturave, kriteret që variojnë sipas nevojave specifike të programit të studimit. Kriteret i dërgohen zyrës së Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pasi përpunohen prej saj, përcillen tek rektori i cili i miraton ato. Shpallja e njoftimeve për vendet vakante publikohet jo vetëm në web faqen e Institucionit por edhe në rrjete sociale e deri në televizione dhe periodikë.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Zyrës së Burimeve Njerëzore u kërkua të shikohej e verifikohej procedura për rekrutimet më të fundit dhe dokumentacioni që ka shoqëruar procesin dhe u konstatua se në dosjet respektive ishin ruajtur dokumentat e kërkuara.</p> <p><i>Aneksi Nr.11 Rregullore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore</i> <i>Aneksi 11.1 Politika te BNj, Politika te punesimit</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, ka në përbërje të tij edhe staf ndihmës akademik, të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e laboratorëve. Gjatë orëve të laboratorit, stafi akademik përgjegjës për lëndët në të cilat do të zhvillohen laboratorët, do të kryejnë laboratorët në prezencë të stafit ndihmës akademik, i cili asiston në mbarëvajtjen e këtij procesi.</p>

<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p><i>Aneksi Nr.20 Syllabuset 2021-2024 (pjesa praktike).</i> <i>Aneksi Nr. 22 CV e stafit ndihmës akademik (Përshkrimi i punës i stafit ndihmës akademik)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UAMD ka në strukturën e tij edhe Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ të punësuar. Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i nevojshëm dhe i gjithë dokumentacioni është i përfshirë në një dosje të vetme.</p> <p>GVJ u informua se të dhënat përditësohen periodikisht në fillim të vitit akademik ose atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. shtimi i ndonjë gradë shkencore ose titulli akademik, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 23 Të dhëna tabelare për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Përgjegjëse</i> <i>Aneksi Nr.11 Rregullore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me grupe interesi dhe partnerë si në fushën e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me subjekte private dhe shtetërore. Institucioni si edhe subjekti pritës për praktikën firmos kontratën e praktikës në të cilën përcaktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet mes palëve. Subjekti pritës e udhëzon dhe e angazhon studentin gjatë periudhës së praktikës në detyra të ndryshme që lidhen me objektivat e formimit të programit të studimit, duke patur gjithmonë një person (punonjës të kompanisë) i cili mbikëqyr dhe udhëzon studentin.</p> <p>Konkretisht, Departamenti i Turizmit ka nënshkruar dhe aktualizuar shumë nga marrëveshjet me subjekte private dhe turistike, sikundër me institucione qeverisëse siç janë: Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, (DRKK), CEAPAL dhe Risi Albania. GVJ konstatoi se këto kontrata përdoren edhe në veprimtari të tjera si paktika mësimore, leksione jashtë auditorit, punimet e diplomave, etj.</p> <p><i>Aneksi 44 Rregullore e praktikave mesimore ne FB</i> <i>Aneksi Nr.34, Aneksi 34.1 Tabele permbledhese me Institucione Bashkepunuese UAMD.</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me Stafin Akademik dhe Studentët</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet</p>	<p>Subjekti pritës, për praktikën profesionale të studentit, përcakton një person përgjegjës i cili duhet të udhëzojë studentin në të gjitha detyrat që ai duhet të kryejë.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit relacionin e praktikës, të cilën më pas e prezanton para komisionit të ngritur në nivel</p>

<p>të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>departamenti. Pas përfundimit të praktikës, studenti dorëzon relacionin e praktikës shoqëruar me një formular vlerësimi për të të bërë nga subjekti në të cilën është kryer praktika profesionale.</p> <p>GVJ konstatoi se me riorganizimin e ri të këtij PS, praktika profesionale do të realizohet vitin e tretë akademik i cili korrespondon me vitin akademik 2023-2024. Në të është parashikuar personel akademik i cili do ndjekë në mënyrë të vazhdueshme, praktikën e studentëve në bizneset e përcaktuara.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në këtë program studimi të ciklit të parë "MTMHR" është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me profile ne pershtatshmeri me lendët e programit, si dhe ngarkesa mësimore mbulohet në masën të paktën 70% nga personel akademik efektiv, sikurse kërkohet nga parashikimet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është personel i cili është prej vitesh pjesë e UAMD, duke dëshmuar kështu qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</i></p> <p><i>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, si dhe Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar.</i></p> <p><i>Institucioni ka marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani në kuadër të realizimit të praktikës profesionale, punimit të diplomës apo veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit dhe vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion, GVJ konstaton se UAMD e zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimit si bibliotekë, sallë interneti, etj. Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se në funksion të</p>



<p>të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>fakultetit / departamentit ka në dispozicion salla për leksione dhe për seminare, sallë interneti, sallë për bibliotekë dhe laboratorë kompjuterësh përveç ambienteve të tjera mbështetëse për programin si mjedis për fotokopje, zyra informimi, zyra për stafin dhe drejtuesit, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 42 Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV, GVJ konstatoi se ambientet mësimore në UAMD ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor teorik e praktik. Laboratorët kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës laboratorike.</p> <p><i>Aneksi Nr. 42 Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion, ambjentet e UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit ka në dispozicion laboratorë informatike. Ata janë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programe profesionale, të cilat mund të ndihmojnë dhe aftësojnë studentët nga ana praktike. Ato janë në dispozicion të studentëve për t'u shfrytëzuar për realizimin e detyrave të kursit apo punimet e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Shfrytëzimi i këtyre laboratorëve nuk është i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve të programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p><i>Aneksi Nr. 42 Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët e programit dhe vizita në ambjentet e UAMD</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD zhvillon veprimtarinë mësimore në ndërtesat e veta të cilat kanë një infrastrukturë të kompletuar, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


rs

Ar

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në Institucion, nga takimet me stafin akademik, evidenton se literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përdorur është literaturë e viteve të fundit dhe garanton përcjelljen në mënyrë efektive të dijeve dhe njohurive tek studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>Aneksi Nr. 42.3 Rregullorja e bibliotekes shkencore</i> <i>Aneksi Nr. 42.4 Memo per Kalendarin e bibliotekes</i> <i>Aneksi Nr. 45.1 Lista kryesore e titujve të hedhur në sistemin elektronik të Bibliotekës UAMD (1)</i> <i>Aneksi Nr.45. 1 Lista kryesore e titujve të hedhur në katalogun elektronik të Bibliotekës UAMD Ekonomia dhe Turizmi</i> <i>Aneksi Nr. 45.2 link informues /U library</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të programit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV si dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se stafi që punon në bibliotekën e universitetit njofton njësinë përgjegjëse dhe lektorët e saj për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit qoftë në gjuhën shqipe dhe atë të huaj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 42.4 Memo per Kalendarin e bibliotekes</i> <i>Aneksi Nr. 45.1 Lista kryesore e titujve të hedhur në sistemin elektronik të Bibliotekës UAMD (1)</i> <i>Aneksi Nr.45. 1 Lista kryesore e titujve të hedhur në katalogun elektronik të Bibliotekës UAMD Ekonomia dhe Turizmi</i> <i>Aneksi Nr. 45.2 link informues /U library</i> <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik të programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Institucioni si dhe vizitës në ambietet e institucionit, GVJ konstatoi se UAMD ka tri biblioteka në kampusin universitar (mbi 12.000 njësi bibliotekare), si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Biblioteka Nr. 1 (160 m²) dhe i shërben Fakultetit të Studimeve Profesionale, Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe FASTIP-it</i> 2. <i>Biblioteka Nr. 2 (220 m²), pranë kampusit universitar, që i shërben Fakultetit të Biznesit dhe Fakultetit të Edukimit.</i> 3. <i>Biblioteka Nr. 3 (35 m²), pranë godinës Nr 2, kampus, e cila i shërben FSHP-J-së (jo e kompletuar plotësisht. Mungojnë libra, vende për studim, kompjutera, internet)</i>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e</p>	

18


<p>mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se UAMD zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu është në dispozicion të studentëve një bibliotekë e pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Njekohesisht biblioteka ekziston edhe në formatin e librit elektronik, i ruajtur në CD, server, hard disk i jashtëm (mbi 10000 tituj). Nëpërmjet sistemit “Koha”, “pa kosto” studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të sigurojnë informacion edhe jashtë ambienteve të universitetit. Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, të cilët janë të lidhur me bibliotekën online EBSCO. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u njoh me ambientet e bibliotekës dhe procedurat e përdorimit të saj nga ana e studentëve. Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore në gjuhën shqipe të hartuar nga pedagogë të këtij universiteti si edhe nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. UAMD ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Studentëve u mundësohet dhe akses në Bibliotekën Dixhitale. Gjatë vizitës në sallën e bibliotekave të universitetit, GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet pa kufizim akses në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online të Universitetit.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p><i>Aneksi Nr. 45. 1 Lista kryesore e titujve të hedhur në katalogun elektronik të Bibliotekës UAMD Ekonomia dhe Turizmi</i> <i>Vizita në institucion, biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Salla e Bibliotekës së Institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të arritjes së objektivave primare të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre duhet të koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Orari i funksionimit të bibliotekës është nga e hëna në të premte në orarin 08:00-14:00 gjatë ndjekjes së programeve bachelor. Nga ana e GVJ kjo fashë orare konsiderohet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor për atë numër të studentëve të programit të studimit Bachelor dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të</p>	<p><i>Aneksi Nr.42.3 Rregullorja e bibliotekës shkencore</i> <i>Aneksi 42.4 Memo per Kalendarin i bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, biblioteka</i></p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, në</p>

18.


<p>bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>kuadër edhe të projekteve në të cilat ka marrë pjesë, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p> <p><i>Aneksi Nr. 42.2 Plani strategjik i Bibliotekës së Universitetit</i> <i>Aneksi Nr. 3.1 Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2021-2025</i> <i>neksi Nr. 45.1 Lista kryesore e titujve të hedhur në sistemin elektronik të Bibliotekës UAMD, Aneksi 45.3 Aksesit në Bibliotekat Digjitale EBSCO, JSTOR,</i> <i>Aneksi 45.3 Marreveshje E Bibliotekës për të përdorur Aksesin Elektronik</i> <i>Vizita në institucion, biblioteka.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Gjithashtu ky institucion ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni menaxhon të dhënat e tij përmes platformës Pitagora. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin dhe me emailin institucionale. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretaria dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Regjistrimit të arritjeve akademike dhe Regjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p><i>Aneksi Nr.9 Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr. 131 Raport mbi Shërbimet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit,</i> <i>Aneksi 12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i> <i>Aneksi Nr. 131 Raport mbi Shërbimet e Sektorit</i> <i>Vizitë në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm Pitagora disponon informacion edhe mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ. Ky informacion i shërben zyrës juridike të depozitohet një dosje të veçantë për gjithë personelin, si dhe krijon një lidhje ndërmjet sekretarisë mësimore, pedagogut dhe fakultetit.</p> <p>Sistemi u mundëson informacion studentëve, personelit akademik dhe atij administrativ, zyra të ndryshme në institucion. Studentëve u mundëson informacion lidhur me planprogramin e lëndës, vlerësimet e tyre, etj.; personelit akademik u mundëson informacion mbi statusin e studentit, rezultatet akademike të studentit, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 8 Rregullore e NJSBC UAMD</i> <i>Aneksi Nr. 99 Manual për Sistemin e Brendshëm për Sigurimin e Cilesise në Fakultetin e Biznesit_V.A.</i> <i>Aneksi Nr. 96.2 Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, ky Fakultet gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe Classroom janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internet të UAMD (www.uamd.edu.al), momentalisht në shqip.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p><i>Aneksi Nr. 39.1. Sistemi Pitagora-RASH</i> <i>Aneksi Nr. 46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit, Aula Aneksi 46.1 Udhëzues për përdorimin e platformave online Classroom, Microsoft Teams</i> <i>Aneksi Nr.47. Të dhëna nga faqja zyrtare në WEB</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme,</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitetet e ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UAMD, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin</p>

<p>publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>mësimor të programit të studimit, jepet informacion për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj.</p> <p>GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</p> <p><i>Aneksi Nr. 47 Të dhëna nga faqja zyrtare në WEB</i> <i>Aneksi 114 Korrespondence me email per njoftimet sociale</i> <i>Website: www.uamd.edu.al</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p> <p><i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UAMD, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Buxheti i alokohet sipas Njësive Kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. GVJ konstatoi se UAMD ka siguruar një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Njëkohësisht, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Aneksi Nr. 3.1 Plani i zhvillimit strategjik te UAMD 2020-2025</i> <i>Aneksi Nr. 49.1 Veprimtaria financiare për vitin akademik 2018 -2019</i> <i>Aneksi 49. Të dhëna nga raporti financiarë vjetorë_mujor institucional</i> <i>Aneksi 50. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit</i></p>



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni në hartimin e planit financiar përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e numrit të stafit akademik, me qëllim plotësimin e standarteve student/pedagog; • Kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, brenda dhe jashtë vendi; • Përmirësimi cilësor i laboratoreve shkencore • Abonimi në revista shkencore dhe biblioteka online; • Përmirësimi i kushteve higjienosanitare; • Rritja e konkureshmërisë së stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare. <p>GVJ konstatoi se procesi i hartimit të projekt buxhetit është gjithpërfshirës. Njëkohësisht, institucioni kryen auditim periodik dhe raporti financiar i cili përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Aneksi Nr.49 Të dhëna nga raporti financiarë vjetorë – mujor institucional</i> <i>Aneksi Nr. 49.1 Veprimtaria financiare për vitin akademik 2018 -2019</i> <i>Aneksi Nr. 47 Të dhëna nga faqja zyrtare në WEB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>UAMD paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Zyra e Financës është përgjegjëse për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet afatmesme dhe ato synojnë garantimin e mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 49.1 Veprimtaria financiare për vitin akademik 2018 -2019</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të</p>	<p>UAMD dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 49.1 Veprimtaria financiare për vitin akademik 2018 -2019</i></p>

përmirësimin të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.				
Konkluzione	<i>UAMD dhe programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Procedurat e hartuara që mbulojnë ciklin e parë të studimeve nga hyrja në dalje reflektohen në Rregulloren Institucionale të UAMD; Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit ; Rregulloren e Departamentit të Turizmit dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor “MTMHR”. GVJ kostaton se të gjitha dokumentet e mësipërme janë hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre. Njëpërmjet tyre zbatohen politikat dhe procedurat që përfshijnë gjithë aktivitetin akademik të studentëve gjatë të gjithë ciklit të studimeve. Ndër të tjera janë të parashikuara procedurat e propozimit dhe miratimit të kuatave, të kriterëve të pranimit, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, rregullat e vlerësimit të njohurive të studentëve, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të studentëve, të ndjekjes së programeve të ciklit të parë.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p>

	<p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat në lidhje me pranimin, përparimin e studentëve, frekuentimin dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese janë të rregulluara nëpërmjet Rregullores Institucionale të UAMD; Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Biznesit ; Rregulloren e Departamentit të Turizmit dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor “MTMHR”. Pranimi i kandidatëve të rinj bëhet konform udhëzimeve të MAS dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore (fakulteti) e të miratuara në Senatin Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantoohen nga rregulloret. GVJ konstaton se UAMD ndjek një proces transparent dhe jo diskriminues, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithsecilit student.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev.10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev 12. Rregullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret për t’u pranuar në ciklin e studimeve 3-vjeçare Bachelor “MTMHR” përcaktohen nga MAS dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Në Rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm ose profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS).</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p>

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit e transferimit të tyre janë të evidentuara sipas Statutit të UAMD, Rregullores Institucionale të UAMD; Rregullores se Brendshme të Fakultetit të Biznesit ; Rregullores së Departamentit të Turizmit dhe Rregullores së programit të studimit Bachelor “MTMHR”. Njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë UAMD u mundësohet studentëve sipas Rregullores së UAMD. Kriteret dhe procedurat e pranimit e transferimit janë lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme nga studentët në faqen web të UAMD https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/ dhe në evidencën <i>Ev 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i></p> <p><i>Ev.2. Statuti i UAMD</i> <i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev.14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR</i> <i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i> <i>Ev 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik UAMD realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre ne “Bachelor në Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim “ Hotel- Restorant”, duke publikuar informacione e shpërndarë njëkohësisht broshura e fletëpalosje informuese. Gjatë takimit në institucion, GVJ u informua se përcjelljen e kërkesave e kriterëve të programit për publikun dhe të interesuarit, UAMD e realizon edhe nëpërmjet aktiviteteve të tjera të realizuara në koordinim edhe me Zyrën e Studentit dhe Karrierës. Disa nga format e promovimit përfshijnë; ditët e hapura, panairi work&study, dhe aktivitete të ndryshme sensibilizuese të cilat promovohen edhe në webfaqen e institucionit. <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit; Ev.94. Promocion mbi programin ne media dhe media sociale</i></p> <p>Informacionet që lidhen me programet e studimit publikohen në faqen e internetit të UAMD, si dhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD. Nga</p>

	<p>konstatimi i GVJ faqja Web zyrtare e UAMD https://uamd.edu.al/ si edhe ajo e Fakultetit të Biznesit, përmbajnë informacione lidhur me programin.</p> <p>https://uamd.edu.al/fakulteti-i-biznesit/</p> <p>https://uamd.edu.al/departamenti-i-turizmit/</p> <p>https://uamd.edu.al/menaxhim-hoteleri-restorant/</p> <p><i>Ev. 47. Te dhena nga faqja Zyrtare WEB e UAMD</i></p> <p><i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i></p> <p><i>Ev.94. Promocion mbi programin ne media dhe media sociale</i></p> <p><i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i></p> <p><i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i></p> <p><i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i></p> <p><i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kritereve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senatin Akademik duke garantuar në hyrje të drejta të barabarta për të gjithë studentë, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantohen nga rregulloret përkatëse të UAMD, dhe Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i></p> <p><i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i></p> <p><i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i></p> <p><i>Ev.123.3 Vendime Bordi per bursat studentore ne fushat prioritare</i></p> <p><i>Ev.123.4 Shperndarje Bursash per programe studimi prioritare e studenteve ne nevojë</i></p> <p><i>Ev.2. Statuti i UAMD</i></p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p> <p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev 117. Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Shtetasit shqiptarë, shqipëtarët jashtë kufijve shtetërorë, si dhe shtetasit e huaj kanë të drejtën të ndjekin studimet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MAS, statuti i UAMD dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë.</p>

	<p><i>Ev.2. Statuti i UAMD</i> <i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i> <i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i> <i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UAMD studentëve me arritje të lartë akademike u akordohen bursa studimi dhe përjashtohen nga tarifa e studimit sipas meritës së mesatares.</p> <p>Gjithashtu për kategori të veçanta të studentëve me aftësi ndryshe apo në nevojë aplikohen tarifa të reduktuara.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i UAMD</i> <i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i> <i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i> <i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i> <i>Ev.123. Shembull ndarje informacioni për bursa</i> <i>Ev.123.3 Vendime Bordi per bursat studentore ne fushat prioritare</i> <i>Ev.123.4 Shperndarje Bursash per programe studimi prioritare e studenteve ne nevoje</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka hartuar politika dhe procedura të qarta për të trajtuar çështjet si pranimi i studentëve të rinj, transferimi i studentëve nga një program në tjetrin, njohja e dijeve, vlerësimi i studentëve dhe diplomimi. Pranimi i kandidatëve bëhet konform udhëzimeve të MAS, kuotave të propozuara nga njësia bazë dhe kriterëve të përcaktuara nga njësia kryesore e të miratuara në Senatn Akademik, ndërsa barazia dhe të drejtat e njëjta për studentët e programit të studimit garantohen nga rregulloret institucionale e të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

18.



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Departamenti i Turizmit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretaria mësimore vënë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve</p> <p>Ndihmë në procesin e infomimit të studentëve të ciklit të parë japin dhe pedagogët e departamentit të turizmit të cilët asistojnë dhe orientojnë studentët gjatë periudhës së studimeve në Bachelor “MTMHR”.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i> <i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i> <i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UAMD përmes Fakultetit të Biznesit, Departamentin e Turizmit orienton studentët në lidhje me përmbajtjen dhe organizimin e programit të studimit, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer, sezonet e provimeve etj Drejtuesi i Departamentit bashkë me stafin akademik të programit bëjnë pritjen e studentëve dhe prezantimin e programit mësimor në javën orientuese. Gjatë javës së orientimit realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UAMD.</p> <p>Kriteret e procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme janë të unifikuara në nivel Institucioni dhe paraqiten në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i></p>

	<p><i>Ev.7. Rregullore e Programit te studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i></p> <p><i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i></p> <p><i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i></p> <p><i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i></p> <p><i>Ev. 102. Njoftim ne mediat sociale per hapjen e procedurave ne rregjistrimin ne nivelin bachelor</i></p> <p><i>Ev. 103.Memo per kriteret e pranimit dhe kuotat e studenteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve janë të unifikuara në nivel Institucioni dhe paraqiten në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit. Në rregulloret përkatëse paraqitet sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e provimeve; shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe rishikimin e notës.</p> <p>Në syllabuset e secilës lëndë të programit Bachelor “MTMHR” ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Njohuritë e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti i Turizmit dhe janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Ev.7 Rregullore e programit te studimit MTMHR.</i></p> <p><i>Ev.14 Dosja e riorganizimit te programit të studimit MTMHR</i></p> <p><i>Ev.112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i></p> <p><i>Ev.20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Detyrimet Përmbyllëse organizohen në formën e një provimi përfundimtar kur studenti ka një mesatare nën notën 7, dhe punim diplome për studentët me mesatare mbi notën 7.</p> <p>Kriteret e punimit të diplomës janë të specifikuara në rregulloren e detyrimeve përmbyllëse dhe rregulloren e diplomimit dhe u bëhen të ditura studentëve përmes departamentit të Turizmit. Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomës zhvillohen seancat përgatitore ku</p>


	<p>pedagogu udhëheq studentët për punimin e diplomës dhe përmbushjen e detyrimeve lidhur me diplomimin.</p> <p>Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10.1 Rregullore e Tezes së Diplomës në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 105.1 Shembull mikroteze në ciklin Bch në MHR</i> <i>Ev. 105. Formulare për percaktimin e udhëheqesit të diplomës, për ciklin e parë të studimeve bachelor</i></p>				
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik UAMD organizon javën informuese me studentët, ku u jepen informacionet e nevojshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e programeve të studimit. <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i> Pjesë e takimeve të hapura është dhe Dita e Informimit të Maturantëve ku janë organizuar takime informuese në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të Durrësit dhe Rretheve të tjera.</p> <p>Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit.</p> <p>Gjatë javës së parë orientuese studentët njihen me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, dhe diplomimin.</p> <p><i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i> <i>Ev.94. Promocion mbi programin në media dhe media sociale</i> <i>Ev. 101. Kriteret e aplikimit për aplikimet e studentëve për programin Bachelor MTHR</i> <i>Ev. 102. Njoftim në mediat sociale për hapjen e procedurave në rregjistrimin në nivelin bachelor</i> <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i></p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD është i angazhuar në informimin e studentëve në lidhje me progresin e tyre akademik dhe procedurat për diplomim përmes organeve dhe rregulloreve përkatëse për planifikimin dhe ndjekjen e studimeve.</i></p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="619 1906 810 1989">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="810 1906 1027 1989">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1027 1906 1259 1989">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1259 1906 1490 1989">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit GVJ u informua se UAMD informon studentët nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët. Universiteti ka struktura të veçanta për pritjen, informimin e studentëve si Sekretaria mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p> <p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit mbi organizimin, kohëzgjatjen dhe statusin e programit të studimit. Po kështu ata marrin informacion në javën e parë të fillimit të vitit të parë, ‘Java orientuese’. Këto informacione gjenden të detajuara dhe në rregulloret përkatëse.</p> <p>Departamenti i Turizmit është i angazhuar në çdo fillim semestri me anë të pedagogëve të departamentit të komunikojë informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit</i> <i>Ev.7. Rregullore e Programit të studimit Bachelor Menaxhim Hotel Restorant</i> <i>Ev. 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i> <i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Pedagogët e programit Bachelor “MTMHR” bëjnë publike informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, të pasqyruara në syllabusin e lëndës. Gjithashtu studentët informohen për programin e studimit nëpërmjet guidës për studentët, planit mësimor, rregullores së programit të studimit të cilat janë të publikuara dhe në webfaqen e UAMD.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni janë të angazhuara në funksion të informimit e udhëzimit të studentëve.</p> <p><i>Ev. 7 Rregullore e programit të studimit MTMHR</i> <i>Ev. 14 Dosja e riorganizimit të programit të studimit MTMHR</i></p>

	<p><i>Ev. 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i> <i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>UAMD ka në fuksion Zyrën e Karrierës dhe Alumni me qëllim të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë. Bashkëpunimet me industrinë, biznesin, dhe institucionet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara dhe bëhen publike në faqen e web përmes njoftimeve për punësime, internship-e, trajnime për studentët. UAMD i ka dhënë prioritet organizimit të aktiviteteve të tilla si panairë të punës dhe takime e leksione të hapura me aktorë nga industria si veprimtari që synojnë të orientojnë studentët rreth mundësive për praktika profesionale në bashkëpunim me institucione partnere.</p> <p><i>Ev. 12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i> <i>Ev. 32. Tabele permbledhese me institucione bashkepunuese per realizimin e programit te studimit</i> <i>Ev. 33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar</i> <i>Ev. 35. Raport Analitik mbi Marreveshjet e Bashkepunimit DT</i> <i>Ev. 51.2 Takim Alumni Turizëm _ All4 Tourism</i> <i>Ev. 51.3 Grupi i punes Alumni dhe aktivitetet</i> <i>Ev. 51.4 Pasqyrimi i aktiviteteve të ndryshme të MTHR në mediat sociale</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në fillim të çdo viti zhvillohet Java e Orientimit të Studentëve dhe mbahen takime informuese mbi programin e studimit, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të tij. Departamenti i Turizmit luan një rol aktiv në orientimin dhe këshillimin e studentëve të Programit të studimit Bachelor MTMHR.</p> <p>Përmes faqes zyrtare të web studentët marrin informacion për orarin e mësimor, orarin e provimeve, strukturën mësimore, bibliotekën, rregulloret dhe procedurat e ndryshme të institucionit.</p> <p><i>Ev. 7 Rregullore e programit te studimit MTMHR</i> <i>Ev. 112. Plani mesimor i Bch ne MHR per vitin akademik 2018-2021</i> <i>Ev. 20. Programet e Lendeve ne Bachelor ne MTMHR 2022-2023</i> <i>Ev. 42 Te dhena per Infrastrukturen ne funksion te programit te studimit</i> <i>Ev. 42.2 Te dhena per infrastrukturen Plani-strategjik biblioteka</i> <i>Ev. 133. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</i></p>




	<i>Ev. 51. Politika e Marketingut të programit të studimit, format, transparancat me publikun</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>UAMD ka në përdorim Sistemin Pitagora për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të evidencave nga pedagogët, sekretaria mësimore për studentët.</p> <p>Ky sistem garanton një menaxhim efikas të të dhënave të studentit dhe është lehtësisht i aksesueshëm prej tyre edhe në distancë nëpërmjet aksesit të krijuar nga përdorimi i “user name” dhe “password”, me të cilin studentët janë pajisur në momentin e regjistrimit në programin e studimit. Çdo student sheh programin e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev. 39.1. Sistemi Pitagora-RASH</i> <i>Ev. 46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit</i> <i>Ev. 48. Strategjia e Komunikimit - UAMD</i></p>			
Konkluzione	<i>UAMD ndjek një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve përmes njoftimeve të ndryshme në faqen zyrtare web, njoftimet në ambientet e fakultetit, komunikimin direkt me strukturat përkatëse dhe pedagogët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor në MTMHR” menaxhohet nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Biznesit. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumni në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 27. Të dhëna tabelare mbi regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare</i></p>


	<p><i>Ev. 48. Strategjia e Komunikimit – UAMD</i> <i>Ev. 54. Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit ne UAMD</i> <i>Tabelat RVB</i></p>																
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “MTMHR” mbahet nga Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit.</p> <p>GVJ verifikoi statistikën për ecurinë e studentëve përgjatë këtyre tre viteve të fundit akademike dhe përfshijnë të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, studentë të transferuar sipas viteve akademike të programit.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Numri i studentëve</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> <th>Studentë të transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>42</td> <td>7.16</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>47</td> <td>7.15</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>24</td> <td>7.01</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare</i> <i>Tabelat RVB</i> <i>Ev. 38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p>	Viti akademik	Numri i studentëve	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	2020-2021	42	7.16	0	2021-2022	47	7.15	0	2022-2023	24	7.01	0
Viti akademik	Numri i studentëve	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar														
2020-2021	42	7.16	0														
2021-2022	47	7.15	0														
2022-2023	24	7.01	0														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit menaxhon të dhënat e studentëve të cilat janë të pasqyruara në Regjistrin themeltar dhe në Regjistrin e rezultatve akademike të studentit.</p> <p>Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare</i> <i>Ev. 39.1. Sistemi Pitagora-RASH</i> <i>Ev. 54. Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit ne UAMD</i></p>																
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin</p>	<p>UAMD mbikëqyr dhe dokumenton në mënyrë sistematike të dhëna analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. Këto raporte janë pjesë e</p>																

<p>e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>analizës vjetore që nis nga stafi akademik, departamentet, fakulteti dhe institucioni dhe evidentohen si vijon:</p> <p><i>Ev. 37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise Fakulteti i Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmi</i></p> <p><i>Ev. 38.1. Analiza e Departamentit për programin e studimit MTHR</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjuesve.</p>	<p>Sekretaria mësimore mban statistika për periudhën e studimeve, regjistrimin, notën mesatare në hyrje e dalje, diplomimi. Ndërsa Zyra e Alumnit dhe Karrierës bën gjurmimin e punësimit të studentëve regjistron dhe përditëson bazën e të dhënave të Alumni.</p> <p><i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i></p> <p><i>Ev. 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare</i></p> <p><i>Ev. 54. Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit ne UAMD</i></p> <p><i>Ev. 12 Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i></p> <p><i>Ev.29. Të dhëna tabelare për punësimin real të studentëve Alumni</i></p> <p><i>Ev. 51.3 Grupi i punes Alumni dhe aktivitetet</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD zbaton politika dhe praktika të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për të përmirësuar eksperiencën e studentëve dhe performancën e institucionit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët e UAMD janë të përfshirë në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshilli i Etikës dhe në Këshillat e studentëve. Angazhimi i studentëve rregullohet nga Statuti i UAMD dhe Rregullorja UAMD, Regullarorja e Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i></p> <p><i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i></p> <p><i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>



	<p><i>Ev. 13. Perfshirja e studenteve ne organet vendimarrrese te UAMD</i> <i>Ev. 30.Të dhëna tabelare për njësitë, individët e studentët të angazhuar në Sistemin e Sigurimit te cilesise</i> <i>Ev. 129 Perfshirja e studenteve ne komisione per graden shkencore</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAMD mbështet krijimin e Këshillave dhe Qeverisë Studentore dhe financon aktivitetet e organizuara prej tyre. Kjo e fundit parashikohet në Statutin e UAMD.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i> <i>Ev.3.1. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025</i> <i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i></p> <p>GVJ u informua gjatë takimit se studentët e programit Bachelor MTMHR kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</p> <p><i>Ev. 13. Perfshirja e studenteve ne organet vendimarrrese te UAMD</i> <i>Ev. 30.Të dhëna tabelare për njësitë, individët e studentët të angazhuar në Sistemin e Sigurimit te cilesise</i> <i>Ev. 129 Perfshirja e studenteve ne komisione per graden shkencore</i></p> <p>Pjesë e vlerësimit të cilësisë së UAMD është pyetësori online për studentët nga Njësia Kryesore për vlerësimin e stafit administrativ dhe akademik dhe pyetësori për studentët Bachelor MTMHR mbi përmirësimin e metodikës së mësimdhënies.</p> <p><i>Ev. 40. Formati i Pyetesorit per pedagoget nga studentet</i> <i>Ev. 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i> <i>Ev. 71. Vleresimi i stafit akademik te FB nga studentet, 2021-22</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me NJSBC, GVJ u informua se në fund të çdo semestri NJSBC organizon zhvillimin e Anketimit Studentor për cilësinë e mësimdhënies, për çdo program studimi. Përfundimet e marra nga ky anketim janë objekt diskutimi dhe reflektimi në njësinë bazë dhe përfaqësojnë kontributin e studentëve gjatë procesit të rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e këtyre raporteve gjithashtu përbëjnë një bazë për hartimin e raporteve të analizës mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p>UAMD i kushton vëmendje propozimve të studentëve në organet drejtuese si Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e</p>




	<p>Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës, Këshilli i Etikës.</p> <p><i>Ev.2. Statuti i Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës</i> <i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev 8 Rregullore e NJSBC UAMD</i> <i>Ev. 37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise Fakulteti i Biznesit</i> <i>Ev 99 Manual per Sistemin e Brendshem per Sigurimin e Cilesise ne Fakultetin e Biznesit_V.A.</i> <i>Ev. 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i> <i>Ev. 71. Vleresimi i stafit akademik te FB nga studentet,2021-22</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e UAMD i garanton studentit të drejtën e ankimimit, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë.</p> <p>Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatit e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin me anëtarë të tjerë. Gjithashtu studentëve u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve gjatë plotësimit të pyetësorëve për lëndët, në fund të semestrit.</p> <p><i>Ev.5.Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev. 40. Formati i Pyetesorit per pedagoget nga studentet</i> <i>Ev. 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022</i> <i>Ev. 71. Vleresimi i stafit akademik te FB nga studentet,2021-22</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD mbështet studentët të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje qe lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD ka struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve. Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë:</p> <p><i>Departamenti</i>, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimesor;</p> <p><i>Sekretaria mësimore</i> ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Zyra e karrierës dhe Alumni</i> ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit.</p> <p>Në Rregulloren Institucionale përcaktohen mënyrat e komunikimit të informacionit tek studentët në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme, vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati dhe Dekanati të lidhura me studentët. Gjatë gjithë periudhës së studimeve studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogun, jo vetëm në auditor por edhe nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit të menaxhimit të informacionit të brendshëm.</p> <p><i>Ev.5. Rregullore e re e UAMD</i> <i>Ev.6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Ev.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit</i> <i>Ev. 12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i> <i>Ev. 39.1 Sistemi Pitagora - RASH</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p><i>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it</i> shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi dhe asistencë për kryerjen e aplikimeve.</p> <p><i>Zyra e Karrierës</i> orienton studentët në drejtim të njohjes të tregut të punës dhe procesit të punësimit si përgatitja e CV, shkrimi i letrës së interesit, planifikimi dhe ndjekja e intervistës të punës.</p> <p>Qendra Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash lidhur me punësimin e tyre, si rezultat i gjurmimit të përditësuar.</p> <p>UAMD ka mbështetur aktivitete të përbashkëta me industrinë të zhvilluara nga Qendra e Karrierës në bashkëpunim me njësitë bazë si Panairin e Punës dhe Karrierës.</p> <p><i>Ev. 12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i> <i>Ev. 131 Raport mbi Shërbimet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Ev.. 51.2 Takim Alumni Turizëm 2018-2019.</i> <i>Ev.. 51.3 Grupi i punës Alumni dhe aktivitetet.</i></p>

Handwritten signatures and initials.

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të UAMD që ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumn-it përmes njoftimeve në web dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre</p> <p>Rrjeti “Alumni” synon mbështetjen e studentëve dhe të diplomuarve në UAMD për të thelluar njohuritë e tyre profesionale; ndihmon në rritjen e tyre në karrierë; përfshirjen në projekte dhe edukim të vazhduar.</p> <p><i>Ev. 12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe karrieres</i> <i>Ev. 131 Raport mbi Shërbimet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Ev.. 51.2 Takim Alumni Turizëm 2018-2019.</i> <i>Ev.. 51.3 Grupi i punës Alumni dhe aktivitetet.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjatë takimi në institucion konstatoi angazhimin e UAMD për të përmirësuar përvojën e studentëve dhe për të siguruar se ata kanë mundësi për të adresuar çdo problem ose ankimim gjatë rrugëtimit të tyre të arsimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur evidentohet se, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UAMD, janë ngritur dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucioni, përkatësisht Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe</p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>mësimnxënies të programeve të studimit, si dhe koordinon punën me njësinë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, që është Departamenti i Turizmit.</p> <p>NJSBC monitoron vlerësimet periodike dhe të dhënat e mbledhura nga studentët dhe stafi akademik trajtohen në formën e gjetjeve dhe pasqyrohen në formën e një raporti me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave për rastet kur është e nevojshme.</p> <p>Zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik asistent lektor vlerësohet çdo vit nëpërmjet: formularët e vetëvlerësimit dhe CV e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani. Dega mësimore angazhohet për matjen e performancës së mësimdhënies, në bazë të vlerësimit të studentëve për performancën e lektorëve. Edhe ky proces kryhet në mënyrë të automatizuar përmes projektit CleanScore, duke maksimalizuar vërtetësinë e gjetjeve.</p> <p><i>Aneksi Nr. 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</i> <i>Aneksi Nr. 68 Formular i vetëvlerësimit të performancës së pedagogut</i> <i>Aneksi Nr. 40 Format i pyetësorit nga studentët për pedagogët</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e UAMD-së, format e përmirësimit të mësimdhënies janë të specifikuar në Nenin 6 të NJSBC. Sistemi i sigurimit të cilësisë merr në konsideratë kontrollin që ndjek veprimtarinë e Universitetit përmes vlerësimit të brendshëm. Zhvillimi i modeleve të vlerësimit të brendshëm në sistemin e sigurimit të cilësisë përfshin një sërë kriteresh të tilla si: vetë-analizën; treguesit e cilësisë; vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e studentëve, vlerësimin e programeve mësimore; vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore; vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve kombetare, rajonale dhe më gjerë; pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Një nga mënyrat që përdoret për vlerësimin e cilësisë është organizimi dhe marrja e informacionit nga ana e studentëve me anë të pyetësorëve të hartuar për këtë qëllim. Në përfundim të çdo semestri bëhet anketimi i studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Gjetjet e pasqyruara në raport vihen në dispozicion të stafit dhe të strukturave përgjegjëse. Pjesë e këtyre vlerësimeve periodike të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve është edhe mundësia e trajtimit të ankimimeve.</p> <p><i>Aneksi Nr.8 Rregullore e NJSBC -UAMD,</i> <i>Aneksi 3 Plani Strategjik i UAMD-së 2016-2020, pika 3 & 4, prioriteti 1</i></p>

	<p><i>Aneksi 3.5 Plani Strategjik I Fakultetit te Biznesit 2021-2025</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formati I pyetësorit nga studentët për pedagogët;</i> <i>Aneksi Nr. 71 Vlerësim I stafit akademik te FB nga studentët, 2021-22;</i> <i>Aneksi Nr. 72.1 Modeli i formularit te vlerësimit në Google form;</i> <i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, neni 20;</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjetjet e pasqyruara në raportin e NJSBC bëhen transparente dhe i vihen në dispozicion në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, si dhe i prezantohen strukturave vendimmarrëse të fakultetit. Bazuar në DVV si dhe diskutimet me stafin akademik dhe atë të NJSBC gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD po merr masa nga më të ndryshmet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi Nr. 66 Informacion mbi rezultatet e vlerësimit të stafit akademik nga studentët, v.a 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjetjet e vlerësimeve diskutohen në nivel njësie bazë/kryesore, me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave në vijim, në rastet kur ka. Në përputhje me këto gjetje, Departamentet, me miratimin e Dekanatit, rishikojnë metodologjinë, lëndët, literaturën, etj. me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe procesit të mësimdhënies në vijim.</p> <p>Ndonëse UAMD merr parasysh vlerësimet e ndyshme, GVJ nuk gjeti ndonjë shembull konkret në lidhje me promovimin e shembujve të praktikave të mira, te cilat nxitin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka të ngritura dhe funksionale struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Megjithate, GVJ rekomandon qe ky institucion te ndjekë politika të qarta për promovimin e cilësisë së mësimdhënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe</p>	<p>UAMD, bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe aktet e brendshme rregullatore, ka të ngritur dhe funksionale Njësinë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), si një njësi vlerësimi të përhershme, përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë, funksionimi dhe përgjegjësitë e së cilës janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. NJBSC në nivel Fakulteti, realizon në mënyrë</p>

<p>me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC ne nivel Institucional. Për realizimin e objektivave NjBSC në nivel Fakulteti bazohet në dosjet e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Për realizimin e objektivave të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional. Për menaxhimin e zhvillimit të cilësisë, NjBSC në nivel fakulteti përcakton mënyrën se si menaxhohet zhvillimi i cilësisë, duke u bazuar në vlerësimin e:</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Procese të brendshme – Duke vënë në funksionim sisteme që ofrojnë performancë dhe i përgjigjen pyetjeve mbi saktësinë dhe eficientë të procedurave të sigurimit të cilësisë. - Procese të jashtme – Duke ju referuar qëllimit, vlerave dhe objektivave të institucionit, të cilat i referohen edhe dokumentave strategjike kombëtare dhe studimeve mbi kërkesat e tregut. Gjithashtu, edhe mundësi mbi shkëmbimet studentore, stafit akademik apo atij administrativ në kuadër të projekteve ndërkombëtare.
	<p>Kjo njësi synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike, në mënyrë që çdo aspekt në UAMD të shihet në kuadër të cilësisë, përmes krijimit dhe konsolidimit të kulturës së cilësisë. NjBSC, me zgjerimin e fushës së saj të veprimtarisë, tashmë mbulon edhe funksionet kërkimore dhe administrative.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në</p>	<p>Bazuar në DVV si dhe diskutimet me stafin akademik dhe atë të NJSBC gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në strategjinë që Institucioni harton për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë dhe student, kështu në përbërjen e Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, sipas përcaktimeve ligjore është anëtar edhe një student.</p> <p><i>Aneksi Nr.8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, pjesa e tretë "Misioni, Funksionet dhe Roli i NJSBC, neni 9 "Roli dhe Funksionet e NJSBC", pika 1/a; neni 2 "Strukturat e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Përgjegjësitë e tyre";</i> <i>Aneksi Nr. 53.1 Ligji i Arsimit të Lartë 80,2015;</i> <i>Aneksi Nr.115 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Biznesit;</i> <i>Aneksi Nr.37 Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesis se FB, standarti i cilesise;</i></p>

<p>arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>Një prej proceseve që ndihmon në përmirësimin e cilësisë është edhe vlerësimi i jashtëm i cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucionit dhe programeve të studimit. Në kuadër të këtij procesi, i cili realizohet nga ASCAL, UAMD harton dhe përgatit Dosjen e Vetëvlerësimit, pjesë e së cilës është edhe Raporti i Vetëvlerësimit, i cili kalon për herë të parë procesin e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>Aneksi Nr.57 Vendimi i MASR për hapjen e programit te studimit MTMHR</i> <i>Aneski Nr 112.2 Relacion mbi organizimin 2021-2024, Vendim Senaati mbi riorganizimin nën 20% te programit+Miratim i ministrise per riorganizimin</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Institucioni me anë të politikave për sigurimin e cilësisë mbështet punën e tij për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> a) Zbatimit të Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14- të. b) Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. c) Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin që ai drejton, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit. • Vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit (FB) nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> a) Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë Fakultetin e Biznesit; stafin administrativ dhe stafin akademik Cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucioni për studentët matet kryesisht nga hartimi dhe zbatimi i politikave për shërbimet inovative në universitet, infrastrukturës, faciliteteve, bibliotekës, shërbimeve nga ana e sekretarive mësimore, teknologjisë së informacionit etj. Ky vlerësim realizohet një herë në vit, zakonisht brenda muajit Qershor të çdo viti akademik. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe



mbledhjes së të dhënave realizohet nga NJBSC e fakultetit, e cila ja paraqet rezultatet e tyre Dekanit te FB për vendimarrje dhe analiza të mëtejshme.

- Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:
 - a) përcaktimit të kritereve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar ne modelet e brendshme te UAMD;
 - b) standardeve dhe kritereve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen ne kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;
 - c) rregullores së studimeve për çdo program;
 - d) cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin;
 - e) politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;
 - f) infrastrukturës mësimore;
 - g) ndërkombëtarizimit të programeve;
 - h) monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.
- Vlerësimi i cilësisë së studentëve sigurohet nëpërmjet:
 - a) kritereve të pranimit duke respektuar karakteristikat e programit të studimit;
 - b) kritereve të vlerësimit të studentëve;
 - c) kritereve të vlerësimit të punimeve të diplomave;
 - d) treguesve të rezultateve të të nxënit;
 - e) treguesve të shërbimeve mbështetëse për studentët;
 - f) treguesve të punësimit të të diplomuarve;
 - g) mbështetjes së mobilitetit të studentëve;
 - h) njohjes së studimeve.
- Vlerësimi i cilësisë së personelit sigurohet nëpërmjet:
 - a) kritereve të rekrutimit;
 - b) përshkrimit standart dhe specifik të punës;
 - c) treguesve të performancës nga vlerësimi i studentëve dhe eprorit;
 - d) vlerësimit të performancës nga eprori;
 - e) mbështetjes së mobilitetit;
 - f) standarteve të promovimit;
 - g) nivelit të trajnimit.
- Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor sigurohet nëpërmjet:
 - a) planit strategjik të kërkimit shkencor;
 - b) procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor;
 - c) sistemit të informimit për kërkimin shkencor.

GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit ka në funksion të tij manualin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë viti akademik 2018-2019,

	i cili përmban gjithë detajet ne lidhje me procedurat dhe funksionet e secilit tregues të cilësisë.			
	<i>Aneksi Nr.8 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë neni 9</i>			
Konkluzione	<i>UAMD harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UAMD punon për të arritur rezultate sa më maksimale si në rritjen e procesit mësimor. Institucioni bazuar në rregulloret përkatëse, ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Sigurimin e cilësisë së programeve UAMD e ka realizuar nëpërmjet monitorimeve të përvitshme dhe publikimit të raporteve të analizës mësimore të cilat përfshijnë në pjesë të tyre dhe raporte për sigurimin e cilësisë. Përveç analizës së vlerësimeve nga ana e studentëve, stafi akademik vlerësohet dhe nga cilësia në kërkimin shkencor. UAMD përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC.</p> <p><i>Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD, kreu VII "Sigurimi i Cilësisë" nenet në vazhdim;</i> <i>Aneksi Nr.8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB;</i> <i>Aneksi Nr.40 Formatit i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr.38 Analiza vjetore e departamentit të turizmit</i> <i>Aneksi Nr. 55 Strategjia e Kërkimit Shkencor VKM 710, date 1.10.2017;</i> <i>Aneksi Nr. 72.1 Modeli I formularit të vlerësimit në Google form;</i> <i>Aneksi Nr.14. Dosja e riorganizimit të programit MTMHR</i> <i>Aneksi Nr. 66 Vlerësimi i stafit akademik të FB nga studentet, 2021-22;</i> <i>Aneksi Nr. 97.1 Raporti vjetor i UAMD për v.a 2019-2020;</i> <i>Aneksi Nr. 97. 2 Raport Vjetor i UAMD për v.a. 2021-2022;</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr. 57 Vendimi i MASR per hapjen e programit të studimit MTMHR”;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit harton çdo vit raportet e analizës së punës mësimore në të cilën përfshihen rezultatet e vlerësimit dhe rekomandohen masat që duhen marrë për mangësitë e evidentuara në drejtim të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimet e që duhen bërë në drejtim të cilësisë. Në vazhdimësi bëhen nga Departamenti analiza vlerësuese, krahasuase në kuadër të përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit për programet e ofruara ne fushen e turizmit. Në vazhdimësi bëhen nga Departamenti analiza vlerësuese, krahasuase në kuadër të përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit për programet e ofruara ne fushen e turizmit.</p> <p>GVJ konkludon se IAL përdor mekanizmat e nevojshëm për vlerësimin e cilësisë në disa dimensione duke bërë pjesë të Raportëve të pjesshme dhe vjetore gjetjet e këtyre vlerësimeve, në nivel institucionit, fakulteti, departamenti, dhe programi.</p> <p><i>Aneksi Nr.2 Statuti i UAMD, kreu VII “Sigurimi i Cilësisë” nenet në vazhdim;</i> <i>Aneksi Nr.8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB;</i> <i>Aneksi Nr.40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr.38 Analiza vjetore e departamentit te turizmit</i> <i>Aneksi Nr. 55 Strategjia e Kërkimit Shkencor VKM 710, date 1.10.2017;</i> <i>Aneksi Nr. 72.1 Modeli I formularit te vlerësimit në Google form;</i> <i>Aneksi Nr.14. Dosja e riorganizimit te programit MTMHR</i> <i>Aneksi Nr. 66 Vleresimi i stafit akademik të FB nga studentet, 2021-22;</i> <i>Aneksi Nr. 97.1 Raporti vjetor i UAMD për v.a 2019-2020;</i> <i>Aneksi Nr. 97. 2 Raport Vjetor i UAMD për v.a. 2021-2022;</i> <i>Aneksi Nr. 57 Vendimi i MASR per hapjen e programit të studimit MTMHR”;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>UAMD përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p>NJBSC është struktura përgjegjëse për realizimin e monitorimit të aktivitetit dhe rezultatet e tij i përcillen Rektoratit dhe Dekanateve, dhe gjithashtu rezultatet e pyetësorëve i përcillen edhe stafit e studentëve.</p>



<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga të dhënat e raportuara, janë nxjerrë rekomandime lidhur me rregullsinë e procesit mësimor, cilësinë e mësimdhënies, janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime në rastet kur ka qenë e nevojshme, etj.</p> <p>NJBSC monitoron në mënyrë të vazhdueshme: mënyrën e zhvillimit të lëndëve, rishikimin/përditësimin e tyre; ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës dhe kualifikimin e tij; procesin e mësimdhënies, ruajtjen e cilësisë dhe vlerësimin nga studentët; ecurinë e kërkimit shkencor; ecurinë e bashkëpunimit ndërmjet njësive/strukturave brenda dhe institucionit; përfshirjen e studentëve në veprimtaritë akademike, konferenca, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 66.1 Monitorim i procesit të mesimdhënies nga NJSBC e FB;</i> <i>Aneksi Nr. 2 Statuti i UAMD, Kreu 7;</i> <i>Aneksi Nr. 7 Rregullorja e Programit të studimit MTMHR”;</i> <i>Aneksi Nr 13 Përfshirja e studenteve në organet vendimarrëse të UAMD</i> <i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, Neni 12, Senati Akademik; Neni 16 “Këshilli i Etikës”;</i> <i>Neni 17 komisionet e Përhershme;</i> <i>Aneksi Nr. 4 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit MTMHR;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 17 “Komisionet e Përhershme të Njësive Kryesore;</i> <i>Aneksi Nr. 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë;</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formatit i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr. 72.1 Modeli i formularit të vlerësimit në Google form Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> a) Zbatimit të Pyetësorit të studentit b) Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë c) Vlerësimit të drejtuesit të njësive kryesore për stafin që ai drejton • Vlerësimi i cilësisë së personelit sigurohet nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> a) kritereve të rekrutimit; b) përshkrimit standart dhe specifik të punës; c) treguesve të performancës nga vlerësimi i studentëve dhe eprorit; d) vlerësimit të performancës nga eprori; e) mbështetjes së mobilitetit; f) standarteve të promovimit;



dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>g) nivelit të trajnimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor sigurohet nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> a) planit strategjik të kërkimit shkencor; b) procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor; c) sistemit të informimit për kërkimin shkencor. <p>Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit zbaton metoda të drejtpërdrejta në vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; dëgjime në auditor; testime paraprake dhe përfundimtare; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët.</p> <p><i>Aneksi Nr. 66.1 Monitorim i procesit te mesimdhënie nga NJSBC e FB;</i> <i>Aneksi Nr. 2 Statuti i UAMD, Kreu 7;</i> <i>Aneksi Nr. 7 Rregullorja e Programit të studimit MTMHR”;</i> <i>Aneksi Nr 13 Përfshirja e studenteve ne organet vendimarrëse te UAMD</i> <i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, Neni 12, Senati Akademik; Neni 16 “Këshilli i Etikës”;</i> <i>Neni 17 komisionet e Përhershme;</i> <i>Aneksi Nr. 4 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimi MTMHR;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 17 “Komisionet e Përhershme të Njësisë Kryesore;</i> <i>Aneksi Nr. 8 Rregullore per funksionimin dhe organizimin e sistemit te brendshem te sigurimit te cilesise;</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formati i pyetesorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr. 72.1 Modeli i formularit te vlerësimit në Google form Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të Institucionit, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga anëtarë, me përfaqësues të stafit akademik, stafit administrativ, një ekspert të jashtëm dhe përfaqësues të studentëve aktualë dhe atyre alumni.</p> <p><i>Aneksi Nr 13. Përfshirja e studenteve ne organet vendimarrëse te UAMD</i></p>



<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<p><i>Aneksi Nr. 8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, neni 2, Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre;</i> <i>Aneksi Nr. 2 Statuti i UAMD, kreu 7;</i> <i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD neni 20;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për aktorët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Edhe gjatë vizitës në institucion me këtë njësi, u evidentua qartë ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë.</p> <p><i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, seksioni i dytë “Kërkimi Shkencor”;</i> <i>Aneksi Nr. 6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit Kreu 5, “Kërkimi Shkencor”;</i> <i>Aneksi Nr. 8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, neni 2, Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Edhe gjatë vizitës në institucion me këtë njësi, u evidentua qartë ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të njësisë. Gjithashtu, rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit, i cili shërben si lidhje midis studentëve dhe njësisë së cilësisë dhe njësisive të tjera.</p> <p><i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, seksioni i dytë “Kërkimi Shkencor”;</i> <i>Aneksi Nr. 6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit Kreu 5, “Kërkimi Shkencor”;</i> <i>Aneksi Nr. 8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, neni 2, Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, si dhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneseve me të cilat UAMD, Fakulteti i Biznesit, dhe/ose Departamenti i Turizmit ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës, gjë që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, neni 20;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 17, Komisionet e përhershme të njësisë kryesorë;</i> <i>Aneks Nr. 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, Neni 2, Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre;</i></p>

	<p><i>Aneksi Nr. 30. Të dhëna tabelore për: njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjithashtu eksperiencia që stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësime të vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj.</p> <p>UAMD ka të miratuar Rregullore në nivel institucional, fakulteti, ose departamenti, përmes së cilave bëhet e mundur ndërmjet të tjerash edhe mbrojtja nga diskriminimi apo pabarazia.</p> <p><i>Aneksi Nr. 5 Rregullore e UAMD, neni 20;</i> <i>Aneksi Nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 17, Komisionet e përhershme të njësisë kryesore;</i> <i>Aneks Nr. 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, Neni 2, Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre;</i> <i>Aneksi Nr. 30. Të dhëna tabelore për: njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe NJBSC</i></p>			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konfirmon se përpos dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni në lidhje me procedurat dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në faqen web të UAMD, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë.</p> <p><i>Aneksi Nr. 38 Analiza Vjetore e Departamentit të Turizmit</i> <i>Aneksi Nr. 51. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun;</i> <i>Aneksi Nr. 47 web-i zyrtar: www.uamd.edu.al Ne rjetet sociale si Fb: uamd faqe zyrtareFakultetiibuznesit faqe zyrtare; Departamenti Turizmit faqe zyrtare; Instagram etj;</i> <i>Aneksi Nr. 52 Kodi Etikës së UAMD;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</i></p>

r.h.


	<p><i>Aneksi Nr. 40 Formati pyetesorit per pedagogët nga student; Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Raportet që NJBSC harton mbi gjetjet e proceseve të vlerësimeve periodike që realizon, krahas shpërndarjes përmes e-mail, prezantohen edhe në mbledhje të ndryshme, ku marrin pjesë stafi i institucionit, si dhe përfaqësues të studentëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave të nevojshme për përmirësim.</p> <p>UAMD, në bërjen publike të informacioneve, respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Aneksi Nr. 38 Analiza Vjetore e Departamentit të Turizmit</i> <i>Aneksi Nr. 51. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun;</i> <i>Aneksi Nr. 47 web-i zyrtar: www.uamd.edu.al Ne rjetet sociale si Fb: uamd faqe zyrtare Fakulteti i biznesit faqe zyrtare; Departamenti Turizmit faqe zyrtare; Instagram etj;</i> <i>Aneksi Nr. 52 Kodi Etikës së UAMD;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë;</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formati pyetesorit per pedagogët nga student; Vizita në Institucion, takimi me NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Sikurse është analizuar edhe më sipër, rezultatet e vlerësimit nga vlerësimet periodike mblidhen dhe pasqyrohen në formën raportit, i cili i përcillet strukturave përkatëse. Bazuar në gjetjet e raportit, njësitë bazë dhe kryesore analizojnë rezultatet dhe marrin masa, kur është e nevojshme, për përmirësimin e metodologjisë, lëndëve, literaturës, etj.</p> <p><i>Aneksi Nr. 38 Analiza vjetore e vitit akademik 2021 -2022 e dep Turizmit;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB;</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr 128 Fulbright Scholars ne UAMD</i> <i>Aneksi Nr 122.1 Drejtoria e projekteve</i> <i>Aneksi Nr. 68 Formularët e vetevlerësimit të performancës së pedagogut;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe NJBSC</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online.</p> <p><i>Aneksi Nr. 38 Analiza vjetore e vitit akademik 2021 -2022 e dep Turizmit;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB;</i></p>



	<p><i>Aneksi Nr. 40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr. 83. Vendim për grupin e punës për konferencën e studentëve 2021;</i> <i>Aneksi Nr. 68 Formularët e vetëvlerësimit të performancës së pedagogut;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe NJBSC</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu stafi akademik dhe ndihmës akademik kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Aneksi Nr. 38 Analiza vjetore e vitit akademik 2021 -2022 e dep Turizmit;</i> <i>Aneksi Nr. 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB;</i> <i>Aneksi Nr. 40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët;</i> <i>Aneksi Nr. 68 Formularët e vetëvlerësimit të performancës së pedagogut;</i> <i>Vizita në Institucion, takimi me studentët dhe NJBSC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë publike dhe transparente. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel-Restorant” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Përvoja shumë vjeçare në tregun e arsimit të lartë të UAMD mbështet konsolidimin e programit të studimit “Bachelor në Menaxhim Turizëm me profil Menaxhim Hotel Restorant” në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të programit.
2. Institucioni dhe në vecanti departamenti që ofron programin e studimit ka siguruar të ketë një staf të kualifikuar dhe të qëndrueshëm që kryesisht është në role drejtuese.
3. Lidhjet e programit me bizneset në lidhje me fushën e studimit si dhe numri relativisht i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to është një shenjë e mirë e materializimit në terren të formimit teorik dhe konkretizimit të praktikave profesionale të lëndëve specifike.
4. Infrastrukturat në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe brenda standardeve duke krijuar mundësi dhe lehtësi për procesin e mësimdhënies.
5. Ngarkesa e numrit të studentëve për një pedagog nuk është e lartë, çka premtion për ndjekjen e tyre edhe në veprimtaritë jashtë fakultetit.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e analizave për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor (*Standardi I.2, kriteri 4*)
2. Ndonëse Institucioni merr parasysh vlerësimet e ndyshme në lidhje me cilësinë, ky PS nuk ka ndonjë sistem aplikativ në lidhje me promovimin e shembujve të praktikave të mira, të cilat nxitin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. (*Standardi VI.1, Kriteri 5*)

Rekomandime:

1. Zhvillimi i analizave periodike për përfitimet konkrete të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit mësimor.
2. Institucioni duhet të hartojë një strukturë solide dhe kulturë institucionale në lidhje me promovimin e shembujve të praktikave të mira, të cilat nxitin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Tourism Management with a profile of Hotel-Restaurant Management", provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu" Durrës University

Strengths and affirmations:

1. The extensive experience in the higher education market of UAMD supports the consolidation of the study program in alignment with the mission and objectives defined in the program development strategy.
2. The institution and in particular the department offering the study program has ensured to maintain qualified and permanent staff being mainly in management duties.
3. Program relations with businesses, as well as the relatively high number of cooperation agreements with them, is a good sign of materialization in the theoretical training and concretization of professional practices of specific subjects.
4. The infrastructures available to the program are sufficient and within the standards creating opportunities and facilities for the teaching process.
5. The number of students for a lecturer is not high that promises to pursue them in activities inside as well as outside the faculty.

Weaknesses:

1. Lack of analysis for the concrete benefits of cooperation agreements in support of the implementation of the study program (*Standard I.2, Criterion 4*)
2. Although Institution takes into account various evaluations related to quality, this program of study does not have any concrete system related to the promotion of good practices on teaching and research, which encourage academic staff to further improve teaching and scientific research. (*Standard VI.1, Criterion 5*)

Recommendations:

1. The institution must perform periodic analyses for the concrete benefits of cooperation agreements in support of the study program.
2. The institution must establish a solid structure and institutional culture regarding the promotion of good practices, which encourage academic staff to further improve teaching and scientific research.

rs.


Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X